**Mal Berisha**

# S H Q I P T A R I A D A

## E SIR NOEL MALCOLM-IT

## MIRËNJOHJA ËSHTË PARAMETËR I FISNIKËRISË NJERËZORE

**Shtepia Botuese dhe shtypshkronja FLESH**

**Tiranë, Tetor 2023**

**Mal Berisha**

# S H Q I P T A R I A D A

## E SIR NOEL MALCOLM-IT

E përbërë prej:

**KOSOVA – NJË HISTORI E SHKURTËR**
**AGJENTË PERANDORAKË**
**SHQIPTARËT – RREBELËT, BESIMTARËT, TË MBIJETUARIT**

Teskti i plotë i tërë materialit të folur dhe të shkruar në serialin filmik dokumentar:

## MIRËNJOHJA ËSHTË PARAMETËR I FISNIKËRISË NJERËZORE

**Shtëpia Botuese dhe shtypshkronja FLESH**

**Tiranë, Tetor 2023**

**Titulli në origjinal:**

# SHQIPTARIADA

**E SIR NOEL MALCOLM-IT**

**Art Grafik: Prf.Dr. Bardhyl Musaj**

**© Copyright Mal Berisha**

Të gjitha të drejtat për këtë libër janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose të transmetohet, në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues pa lejen paraprake të autorit.

**ISBN: 9789928346315**

**Mbështetur nga:**

**Dr. Ahmet Ulaj**

**Autori:**

**Mal Berisha**

**Website: www.Malberisha.com**

Sir Noel Malcolm, All Souls College, Universiteti i Oksfordit.

**Disa fjalë nga autori**

Nga viti 2012 deri në vitin 2015 kam pasur nderin të shërbeja Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Gjatë asaj periudhe pata rastin të takoj një nga historianët më të shquar të kohës sonë dhe më të shquarin ndër ata që kanë shkruar për historinë e shqiptarëve. Ky ishte Sir Noel Malcolm, nga All Souls College, në Oksford, Angli.

Pasi lexova dhe studiova veprën e tij, e cila ishte botuar para se të shkoja në Londër, "Kosova – Një Histori e Shkurtër", gjatë qëndrimit tim atje, "Agjentë Perandorakë" dhe pasi mbarova detyrën, "Rrebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit", vendosa të gjej një mënyrë për të bërë të njohur më gjerësisht të vërtetat e thëna për shqiptarët nga Sir Noel Malcolm në ato 1600 faqe të këtyre librave.

Pas kësaj besova se mënyra më e mirë për ta bërë këtë ishte të prodhoja një film dokumentar në të cilin do të shfaqeshin konsideratat analizat dhe opinionet e individëve më kompetentë shkencërisht në lidhje me punën e tij.

Prodhimi i filmit kërkonte përpjekje, udhëtime dhe bashkëpunim të gjerë gjatë dy viteve. Së fundi, mund ta prezantojmë këtë serial dokumentar në tre episode, të titulluar:

**"MIRËNJOHJA ËSHTË PARAMETRI I FISNIKËRISË NJERËZORE".**

Krahas filmit dokumentar mendova gjithashtu se do të ishte e vlefshme të publikoja tekstin e plotë të intervistave me njëzet e tre ekspertë të cilët kanë shprehur mendimet e tyre për punën e Sir Noel Malcolm në këto vepra.
Këtë mendova ta titulloja:

**SHQIPTARIADA E SIR NOEL MALCOLM-IT**

**Prapavështrim**

Në fëmijërinë time, rininë, pjekurinë dhe burrnimin, përkrah gjërave më të rëndësishme të jetës ka ekzistuar edhe shqetësimi për fatin e Kosovës, sa edhe dashuria për atë pjesë të bukur të vendit tonë.
Ndjenja e njeriut që ka lindur në buzë të kufirit politik midis trojeve të përbashkëta etnike shqiptare, lë gjurmë të thella në ndërgjegjjen e tij. Në vitet e para të jetës isha mësuar që në shtëpinë time të flitej thuajse çdo ditë për Kosovën, për burrat e shquar, miqësitë me

familje nga rrethinat e Gjakovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, këngët për Azem Bejtën, Isa Boletinin etj.
Më vonë, kur familja ime u zhvendos nga vendlindja, banorët e parë me të cilët u njohëm ishin kosovarët e Mamurrasit. Ne i quanim ata "kosovarë", edhe pse mes tyre kishte asish që vinin nga troje të tjera shqiptare jashtë kufirit, si nga Vuthajt, Plava e Gucia, Ulqini, Tetova, Dibra e Madhe... Por, për ne, të gjithë ata ishin "kosovarë".
Njohja me burra të tillë, shoqërimi me ta dhe ndjesia që ata përcillnin tek ne rreth asaj që kishte ndodhur dhe ndodhte çdo ditë Kosovë, për çka ishin gjithmonë të mirëinfomuar më bënte pëherë e më të vetëdijshëm.
Prej tyre mësova për Masakrën e Tivarit, për krimet e Rankoviçit, për "Aksionin e Armëve", për ngjarjet e vitit 1968, për demonstratat e studentëve, për Kushtetutën e vitit 1974, demonstratat e vitit 1981 dhe fundin tragjik të shumë prej pjesëmarrësve. Mësova për Tubimin në Gazimestan, në qershorin e vitit 1989, për abrogimin Autonomisë së Kosovës, për elaboratin famëkeq "Dëbimi i Shqiptarëve" të Vaso Çubriloviçit në klubin serb të Sarajevës në vitin 1937, dhe për shumë ngjarje të tjera të rënda.

Ishin shumë djem kosovarë ose, më mirë të themi, shqiptarë prej andej kufirit që vinin të jetonin në Shqipëri. Ata bartnin shqetësimin jo vetëm për atë që ndodhte në Kosovë, por edhe për fatin e atyre vetë në Shqipëri. Regjimi komunist herë pas here gjente shkaqe nga më absurdet dhe i arrestonte, duke ua shuar ëndrrën e të jetuarit të lirë në "atdheun mëmë".
Në vitin 1992, kam pasur nderin dhe privilegjin e madh të përfaqësoj Shqipërinë në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll.
Ditën kur u nisa për atje, takova Presidentin e shtetit shqiptar, prof. dr. Sali Berisha, të cilit i kërkova të më jepte porositë e rastit.
Ai më tha: "Je i ri në atë detyrë, Turqinë e kemi vend mik. Detyrat teknike i ke marrë në MPJ. Unë do të të ngarkoj një detyrë edhe më të rëndësishme:
Kujdesu për Kosovën dhe kosovarët. Ata udhëtojnë shumë për në Stamboll dhe prej aty mund të bëhen shumë punë të mira për Kosovën!"
Kaq ishte porosia që "më nevojitej". Punën time në ato pesë vjet që punova në konsullatë, do ta orientoja me shumë përkushtim drejt kujdesit të veçantë për Kosovën.
Aty pata rastin të takoj Kryeministrin e Kosovës të kohës, në mërgim, ministrat që më vonë u bënë kryeministra, profesorë të Universitetit të Prishtinës, djem dhe vajza të cilët më vonë u bënë politikanë të lartë në Prishtinë, historianë, artistë, shkrimtarë, mjekë etj.

Në vitin 1998 vendosa të zhvendosem, në mënyrë private, në SHBA. Atje iu kushtova çlirimit të Kosovës me mish e me shpirt, nën ombrellën e Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane, e drejtuar nga ish-kongresmeni amerikan me origjinë arbëreshe, Joseph DioGuardi, dhe Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës VATRA, e drejtuar nga inxhinieri Agim Karagjozi.

Nëntë vite punë në Kosovë, si anëtar i personelit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK, ishin vite të paharrueshme; aty ku ëndrrat e mia ishin vërtitur për dekada të tëra dhe tani ishin bërë realitet: në Kosovën e lirë, demokratike dhe, më së fundi, të pavarur.
Të isha i pranishëm në sallën e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, më 22 korrik 2010, ku u legjitimua e drejta ligjore e Kosovës për të qenë shtet i pavarur, si përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, ishte një nder dhe kënaqësi e veçantë, e shoqëruar me një emocion të papërshkrueshëm.
Pas kësaj erdhi fillimi i punës në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, më 17 shkurt 2012, pikërisht në ditën e përvjetorit të katërt të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Kjo detyrë e re më dha mundësinë të njoh njerëz shumë të rëndësishëm në Britaninë e Madhe, të cilët kishin dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për lirinë e Kosovës.
Ata ishin lordë, parlamentarë, zyrtarë të administratës britanike, intelektualë, historianë, shkrimtarë, poetë dhe shumë të tjerë.

Veçoj midis tyre lordët George Robertson, Michael Bates, Robert MacLennan, Alan Watson, Lord Stuart Peach, Baronin e Etchinghamit, Charles Moore, si dhe parlamentarët Mark Prichard, Karen Buck, Adam Halloway, Edward McMillan Scott, intelektualë si Melanie McDonagh, Harry Eyres etj.

Por, duhet të them se njeriu që më la më shumë përshtypje, ai që e kishte dashur Kosovën pa asnjë interes, as politik, as ekonomik, dhe që kurrë nuk priste asgjë në kthim, ishte profesori i Oksfordit, Noel Malcolm.
Njohja me të ka qenë një bekim që do ta marr me vete gjatë gjithë jetës.
Ndikimi i veprës së tij, "Kosova - Një Histori e Shkurtër", në zgjidhjen e çështjes së Kosovës ishte jashtëzakonisht i madh.
Njohja e mëvonshme me veprat e tjera të Sir Noel Malcolm-it, të cilat ua kushtoi shqiptarëve, më bëri të mendoja se kontributi i tij në dobi të çështjes shqiptare, zbulimi i disa të vërtetave të cilat kurrë nuk do t'i mësonte bota, si ato që ai botoi në librat "Agjentë Perandorakë" dhe "Rrebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit", meritonte çdo mirënjohje që një shqiptar mund t'i ofronte atij. Aq më tepër, nëse ishe edhe përfaqësuesi i Shqipërisë në atë vend aq të rëndësishëm për historinë tonë kombëtare.
Këtij konteksti i jepte edhe më shumë peshë fakti që, Sir Noel Malcolm është President i shoqatës 'bashkëmoshatare' me shtetin tonë shqiptar: "Anglo-Albanian Association".

> *"I bindur për vlerën e jashtëzakonshme të veprës së Sir Noel Malcolm-it për ne shqiptarët, mendova dhe besova se një film dokumentar për jetën dhe veprën e tij, e rrëfyer nga figura të shquara britanike, shqiptare, shqiptaro-britanike ose britaniko-shqiptare, ishte një*

*detyrim dhe shprehje e mirënjohjes së thellë ndaj veprës së tij. Një dokumentar i tillë do të shërbente edhe për të forcuar marrëdhëniet e kombit tonë me Mbretërinë e Bashkuar".*

Prandaj, ky film dokumentar po shoqërohet me këtë libëth ku do të gjeni në dy gjuhët, shqip dhe anglisht, të gjitha intervistat, të transkriptuara dhe të përkthyera.
Me këtë botim, dëshiroj t'u jap mundësinë shikuesve të ciklit dokumentar që të njohin më mirë Sir Noel Malcolm-in, edhe në këtë tekst të shkruar përveç vetë filmit.

**Mirënjohje**

Së pari, dua të falënderoj Sir Noel Malcolm-in për intervistat që më dha në lidhje me veprat e tij kushtuar shqiptarëve. Falenderoj studiuesin e njohur Bejtullah Destani për këshillat bujare që më dha gjatë gjithë procesit. Falenderoj mikun tim Dr. Ahmet Ulaj, pa ndihmën dhe mbështetjen e të cilit nuk do të ishte realizuar ky film dhe ky libër. Falenderoj gjithashtu video-redaktorin Altin Çelmeta dhe ekipin e operatorëve të kamerave të A2 CNN Exclusive. Falenderimet e mia shkojnë për miqtë e mi, shkrimtarin e mirënjohur Besnik Mustafaj, profesor Bardhyl Musaj dhe shkrimtarin shqiptaro-irlandez, Ndrekë Gjini, dokumentaristin e njohur kosovar të filmit Fatmir Lamaj si dhe dy miq të mi amerikano-shqiptarë, znj. Nikki Doçi dhe David Hosaflook. Një falenderim shkon për të gjithë të intervistuarit që u bënë pjesë e kësaj sipërmarrjeje nga Londra, Kembrixhi, Oksfordi, Prishtina, Tirana. Falenderoj gjithashtu të gjithë miqtë e mi që u bënë pjesë e këtij projekti: disa prej tyre filmuan, të tjerë korrigjuan, të tjerë montuan filmin dhe materialin e folur dhe të shkruar. Emrat e tyre janë në fund të tekstit të këtij libri. Dhe në fund falenderoj familjen time, bashkëshorten Donika, për durimin, mirëkuptimin dhe ndihmën e pakursyer që unë të jem "i lirë" të merrem me këtë projekt fisnik.

Faleminderit

**Besnik Mustafaj**

Shkrimtar, ish - Ambassador and Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë

## Parathënie

Ky është një botim *sui generis*. I kushtohet historianit britanik Sir Noel Malcolm. Por nuk ka asgjë të ngjashme me një biografi. Noel Malcolm ka tashmë një opus shumë të gjerë dhe të shtrirë në shumë fusha, të pranuar dhe të vlerësuar lart jo vetëm nga mjediset e akademikëve dhe të dijetarëve, por edhe nga opinioni i gjerë i lexuesve në anglisht dhe në dhjetëra gjuhët ku është përkthyer. Tri nga këto vepra kanë në qendër shqiptarët dhe historinë e tyre. Janë: "Kosova, një histori e shkurtër", "Agjentë Perandorak" dhe "Shqiptarët, Rebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit". Të tri këto vepra janë të botuara edhe në shqip dhe të çmuara. Ky botim përqendrohet kryesisht te këto tri vepra, por nuk është aspak një shqyrtim kriticist i vërtetësisë së fakteve të sjella nga autori dhe as i përfundimeve, në të cilat arrin ai me metodën e tij përmes këtyre fakteve.

Mirëfilli, ky botim është script-i i një filmi dokumentar me tri episode, realizuar nga ambasadori Mal Berisha, kushtuar Sir Noel Malcolm-it. Në të përfshihet një tekst i kursyer, shkruar nga autori me cilësinë e rrëfyesit të filmit, një numër do të thosha po ashtu i kursyer intervistash me protagonistin e veprës si dhe shumë dëshmi personalitetesh britanike dhe shqiptare, të cilët nuk janë të gjithë doemos miq të Sir Noel Malcolm-it në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, por njihen me të dhe më të shumtët kanë si arsye të njohjes me të pikërisht veprën e tij të jashtëzakonshme si historian dhe dijetar, për të cilin, Dr. David Shankland, drejtor i Insitutit Mbretëror Antropologjik, Londër, thotë se ndër bashkëkohësit, është ai që afrohet më shumë me një gjeni në studimet historike moderne. Nuk më duket ndonjë teprim në lëvdatë nga ana e Dr. David Shankland. Edhe pse me fjalë të tjera, të njëjtin vlerësim kanë edhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë punim, të pyetur nga Mal Berisha. Është një përfundim, ku ata arrijnë në sajë të njohjes së gjerë të veprës madhore të Sir Noel Malcolm-it, shto me këtë rast edhe njohjen ku më shumë e ku më pak nga afër të personalitetit të tij si njeri.

Ashtu si filmi dokumentar, edhe ky botim i drejtohet me përparësi publikut shqiptar. Rrjedhimisht, edhe autori Mal Berisha, qysh në koncept, do të përqendrohej kryesisht te tri veprat që Sir Noel Malcolm-i u ka kushtuar shqiptarëve dhe historisë së tyre. Në fjalën hyrëse, shkruar posaçërisht për këtë botim, ambasadori Mal Berisha e ndien të nevojshme t'i përgjigjet pyetjes se çfarë e shtyu të bënte këtë film dokumentar. Dhe thotë:

*"I bindur për vlerën e jashtëzakonshme të veprës së Sir Noel Malcolm-it për ne shqiptarët, mendova dhe besova se një film dokumentar për jetën dhe veprën e tij, e rrëfyer nga figura të shquara britanike, shqiptare, shqiptaro-britanike ose britaniko-shqiptare, ishte një detyrim dhe*

*shprehje e mirënjohjes së thellë ndaj veprës së tij. Një dokumentar i tillë do të shërbente edhe për të forcuar marrëdhëniet e kombit tonë me Mbretërinë e Bashkuar".*

Mirënjohja është një virtut i spikatur në karakterin identitar të shqiptarit. Në këtë rast besoj se kjo mirënjohje bëhet edhe më komplekse nisur nga fakti se kush e shpreh atë.

Mal Berisha ka lënë tashmë emrin e tij të mirë në diplomacinë shqiptare. Përvoja në shërbimin e jashtëm e në mënyrë të veçantë koha e kaluar në drejtim të marrëdhënieve të Shqipërisë me Mbretërinë e Bashkuar e ndihmon mjaftueshëm për ta përjetuar këtë mirënjohje ndaj Sir Noel Malcolm-it jo thjesht si një emocion fisnik, por shumë më gjerë: në këtë kontekst, mirënjohja e Mal Berishës është një përfundim krejt logjik, mbështetur në dhjetëra e dhjetëra fakte madhore, kur libri "Kosova, një histori e shkurtër", për shembull, ka shërbyer në mënyrë vendimtare për përfshirjen e kancelarive politike të fuqive demokratike të botës së sotme në zgjidhjen e nyjës dramatike të Kosovës duke sjellë çlirimin dhe pavarësinë e saj. Vetëdija prej ambasadori e shtyn Mal Berishën të besojë se, me këtë paraqitje të personalitetit të Sir Noel Malcolm-it, do të ndihmojë edhe në forcimin e marrëdhënieve të kombit tonë me Mbretërinë e Bashkuar. Kësisoj, si një nga lexuesit në dorëshkrim të kësaj pune, mbetem i bindur se ambasador Mal Berisha përcjell në këtë rast mirënjohjen e një kombi të tërë në kuptimin më të lartë të kësaj fjale për Sir Noel Malcol-in.

Duket si një mrekulli e Zotit domethënë e vështirë për t'u besuar që një libër, - në këtë rast "Kosova, një histori e shkurtër", - ka patur ndikim vendimtar në ndryshimin e qasjes së kancelarive politike të fuqive të mëdha demokratike ndaj fatit të popullit të Kosovës. Mal Berisha ka gjetur njerëzit me personalitet të plotë, të cilët, duke e pohuar një fakt të tillë, i japin atij një mbështetje të pakundërshtueshme. Por edhe kaq, ndoshta, nuk do të mjaftonte për të bindur publikun e gjerë se kjo ka ndodhur para një çerek shekulli. Mal Berisha, si autor, e mban parasysh këtë rrezik. Ai nuk merr përsipër të na sjellë përmbledhtazi në punimin e tij faktet dhe argumentet e paraqitura në veprën e vet nga Sir Noel Malcolm-i, për të na treguar se ai ka nxjerrë në dritë të vërtetën historike. Mal Berisha kujdeset të skicojë profilin e historianit, i cili e bartë në publik këtë të vërtetë e që është Sir Noel Malcolm-i. Me sa duket, Mal Berisha niset nga një urti e pleqve të vendlindjes së tij, sipas të cilës e vërteta ka sigurisht rëndësinë e vet, por po kaq rëndësi ka edhe kush e shqipton atë. Kështu, ne zbulojmë edhe disa cilësi të vyera morale dhe intelektuale të personalitetit të Sir Noel Malcolm-it, të lidhura këto me arsyet, që e shtynë atë të ndërmerrte një punë kaq të madhe e të vështirë, siç ishte ndriçimi i historisë së shqiptarëve.

Me pak fjalë, mbështetur te ky botim dhe te filmi dokumentar që i ka paraprirë, ne mësojmë se Sir Noel Malcolm-i është në natyrën e tij një burrë romantik, cilësi kjo që e ka frymëzuar gjithmonë për t'iu përkushtuar me pasion të vërtetave të harruara, të shërpfillura apo edhe më keq, të manipuluara nga historiografia dhe nga politika e mbrapshtë, duke sjellë pasoja dramatike për popujt apo bashkësitë njerëzore bartës të këtyre të vërtetave. I tillë është pa dyshim rasti i shqiptarëve në përgjithësi dhe i shqiptarëve të Kosovës në veçanti. Sir Noel Malcolm e kishte dëshmuar tashmë me një

sërë veprash madhore përpara publikut britanik dhe më gjerë integritetin e vet të pacënueshëm, ku kërkimi i të vërtetës ishte dhe mbetej një përkushtim i shenjtë, mbi të cilin ai nuk mund të shkelte për asnjë arsye. Sir Noel Malcolm-i është gjithashtu një burrë me shqisën e kureshtjes jashtëzakonisht të zhvilluar. Dëshmi e saj është edhe fakti se, ndër 23 gjuhët e huaja që njeh, është edhe shqipja. Kjo do t'i shërbente natyrshëm si lehtësi shtesë në hulumtimet nëpër arkiva. Vazhdimi i punës për shkrimin do të ishte çështje metode, vullneti dhe aftësie për të analizuar, të cilat ai i kishte me tepri. Në fjalë të fundit, e vërteta për shqiptarët, për rrënjët dhe për degët e tyre, që do të shprehte ai në afro 1600 faqet e botuara, do të ishte e besueshme për politikanët dhe për opinionin e gjerë publik jo vetëm pse ishte e vërtetë, por edhe se vinte prej penës së Sir Noel Malcolm-it.

Për ta mbyllur këtë shënim, do të nënvizoja edhe një aspekt tjetër, i cili më duket me shumë rëndësi për t'u mbajtur mend. Nisur nga fakti i pranuar se "Kosova, një histori e shkurtër" pati një ndikim pak a shumë jetik mbi vendimet e marra në kancelaritë e fuqive demokratike euro - atlantike në periudhën 1998 – 2007 lidhur me fatin e Kosovës, ne, shqiptarët në përgjithësi, duhet të nxitemi për ta shqyrtuar në mënyrë kriticiste një stereotip të ngulitur si në folklorin edhe në historiografinë tonë zyrtare, domethënë në kujtesën tonë kolektive kombëtare. Është fjala për stereotipin, sipas të cilit, gjatë përplasjeve tona për mbijetesë, fuqitë e mëdha të kohës i kanë mbështetur fqinjët tanë grabitqarë për shkak të frymës së tyre *apriori* antishqiptare. Shembulli i ndikimit për mirë që pati libri i Sir Noel Malcolm-it në vendimet e marra në Londër, në Uashington, në Bruksel, në Paris apo në Berlin gjatë periudhës së lartpërmendur tregon se sjelljet, domethënë anësitëe këtyre fuqive janë shumë shpesh pasojë e mosnjohjes së të vërtetës së shqiptarëve në këto kryeqytete. Një shqyrtim i tillë kriticist i stereotipit në fjalë do të na çlironte disi nga kompleksi i rëndë i viktimës.

## 1 - EPISODI I PARË
## KUSH ËSHTË SIR NOEL MALCOLM

**1. - Rrëfyes Mal Berisha**

Të dashur miq!

Përkrah vështirësive e madje, edhe tragjedive të panumërta që ka përjetuar kombi ynë shqiptar, prapëseprapë duhet thënë se ne kemi qenë të bekuar, pasi përherë na janë gjendur pranë njerëz dhe personalitete me famë botërore.
Ata kanë vënë re tek ne dhe më pas i kanë përshkruar virtytet më të larta të popullit tonë, traditën, besën, kulturën, historinë dhe atë çfarë ne kemi lënë pas me gjurmët tona në trashëgiminë e përgjithshme të njerëzimit.

Pas kësaj, disa prej tyre janë dashuruar me vendin tonë, me popullin tonë, me historinë tonë, me natyrën tonë, me njerëzit, dhe më pas janë përkushtuar që të na bëjnë të njohur tek kombet, popujt dhe gjuhët e tjera të botës.

Jam shumë i lumtur që në cilësinë e ish-Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, kam pasur rastin të njoh, të bashkëpunoj, dhe të kontribuoj për njohjen e veprës së disa prej tyre në lidhje me kombin tonë shqiptar.

Janë aq shumë udhëtarë, poetë, shkrimtarë, lordë, pati prej atyre që më vonë u bënë edhe kryeministra të Mbretërisë së Bashkuar, kryearkitektë, artistë, piktorë, kronikanë, që i kanë vizituar trojet shqiptare nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë e deri më sot.

Është e vështirë të përmblidhet në një film dokumentar veprimtaria e këtyre njerëzve, të cilët e kanë bërë të njohur popullin shqiptar në botën perëndimore e veçanërisht, në botën anglishtfolëse.

Mirënjohja për ta është e pafund, e tillë që nuk duhet të vyshket kurrë.

I tillë është njëri prej mendimtarëve më modernë të kohës sonë filozof, shkrimtar dhe historian.

Ai është Sir Noel Malcolm.

Mirënjohja për këtë personalitet britanik shumë të shquar, është e pafundme.

Kush është Sir Noel Malcolm dhe çfarë ka bërë ai për ne, shqiptarët?

**2 - Kush është Sir Noel Malcolm**

Historiani, analisti, filozofi i shquar anglez, Sir Noel Malcolm, ka lindur në vitin 1956.

Ai ka studiuar Histori dhe Letërsi Angleze në Universitetin e Cambridge, ku edhe ka mbrojtur tezën e doktoraturës mbi veprën e filozofit anglez të shekullit të shtatëmbëdhjetë, Thomas Hobbes.

Ai e ka filluar karrierën e tij si anëtar i kolegjit "Gonville and Caius", në Cambridge;

Më pas u angazhua si analist politik, më pas si redaktor i jashtëm i revistës "The Spectator", dhe në vijim si reporter kryesor politik i gazetës "The Daily Telegraph".

Në vitin 1996, Noel Malcolm ligjëroi në kolegjin "St. Anthony", në Oxford, ndërkohë që në vitin 1999 dha mësim në Universitetin Harvard në Massachusetts, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vitin 2001, Noel Malcolm fillon punën në "All Souls College", në Oxford.

Ai është anëtar i Akademisë Britanike të Shkencave, anëtar nderi i "Peterhouse" në Cambridge dhe në kolegjet "Trinity" e "Gonville and Caius".

Noel Malcolm është anëtar i Jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, dhe anëtar Nderi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 2014, ai është kalorësuar nga Mbretëresha Elizabeth II, me titullin e lartë "SIR", dhe është mbajtës i Medaljes së Artë "LIDHJA E PRIZRENIT", si dhe dekoratën "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU", akorduar nga Presidentët e Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë.

Sir Noel Malcolm është gjithashtu, president i Shoqatës anglo-shqiptare në Londër.

Ajo shoqatë e ka fillesën te Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, i themeluar në vitin 1912 nga miku më i madh i shqiptarëve, diplomati, ushtaraku, studiuesi dhe parlamentari anglez, kampioni i përpjekjeve për të drejtën e Shqipërisë që të bëhej shtet i pavarur, koloneli Aubrey Herbert.

Më vonë, në vitin 1918, ky komitet, nën drejtimin e Herbertit, me pjesëmarrjen e Edith Durham, u kthye në Shoqatën anglo – shqiptare që vepron edhe sot e kësaj dite në Londër.

Midis të tjerash, Malcolm është autor i librave të mëposhtëm:

- *George Enescu*, biografi
- *Dei Dominis*, biografi
- *Thomas Hobbes, Leviathan*
- *Origjina e gjepurave angleze*
- *Aspektet e Hobbes – t*
- *John Pell, filozofi anglez i shek XVI*,
- *Arsyet e Shtetit*
- *Bosnja – Një Histori e Shkurtër*
- *Armiqtë e Dobishëm*

Tri nga veprat e tij kryesore kushtuar kombit shqiptar, janë:

- KOSOVA – NJË HISTORI E SHKURTËR
- AGJENTË PERANDORAKË
- REBELËT, BESIMTARËT, TË MBIJETUARIT

Kombi shqiptar i është mirënjohës këtij historiani të shquar anglez, për kontributin e dhënë ndaj historisë së shqiptarëve.

**3.- Lord Charles Moore**

E takova Noel Malcolm për herë të parë më shumë se 50 vjet më parë, në vitin 1969, kur ne të dy po merrnim bursën për në "Eton". Ne ishim të dy 12-vjeçarë dhe për të dalë nga rutina fëminore, filluam të bisedonim me njëri-tjetrin.
Ai ishte një djalë shumë, shumë i vogël, madje më i vogël se unë.
Ai më tha: "Më ka pëlqyer pyetja për artin, sepse jam një dashamirës i madh i Monet dhe pikturave të Monet."

E pashë që donte të fliste për pikturat e Monet, gjë që ishte krejt e pazakontë për një djalë 12-vjeçar.
Ai dhe unë, të dy morëm bursa në "Eton". Pra, ne ishim në të njëjtën shtëpi atje dhe jemi miq që në atë kohë.
Përshtypja ime e parë për Noelin është e njëjtë me përshtypjen time të fundit, se ai është një person me shkëlqim të jashtëzakonshëm intelektual dhe me një shumëllojshmëri dhuntish.
Pra, ai nuk është vetëm një njeri me intelekt të jashtëzakonshëm, por ai është shumë i lexuar, ai flet shumë mirë, ai është një muzikant jashtëzakonisht i mirë dhe me dijeni shumë të gjera për muzikën. Një ditë, kur u kthyem të dy nga pushimet, mendova me vete: Epo, Noeli i ka të gjitha këto talente, por nuk e shoh të pikturojë apo vizatojë.
Por kur u kthyem nga pushimet e pyeta: Çfarë bëre gjatë pushimeve?
Ai më tha: "Oh, isha në Francë dhe po skicoja disa abacira në Normandi."
Ai kishte sjellë me vete albumin e tij të skicave, plot me vizatime të bukura të këtyre ndërtesave mesjetare. E kuptova se ai mund ta bënte edhe këtë. Madje, ai ishte mjaft i zoti edhe në sport. Dhe kështu, vazhduam të ishim miq.

Edhe në Cambridge shkuam bashkë, por ishim në kolegje të ndryshëm.
Kur Noeli aplikoi për kolegjin ku do të regjistrohej, në Cambridge Peterhouse, ai u intervistua nga Maurice Cowling, i cili është një historian shumë i famshëm politik, një historian i mendimit filozofik.
Maurice Cowling-ut i pëlqente t'i sfidonte njerëzit. Ai e intervistoi dhe në fund i tha Noelit… - i cili ishte shumë, shumë i ri që të intervistohej për Cambridge. Mendoj se ishte vetëm 16 vjeç; u mbështet në karrige dhe e pyeti:
"Ti mendon se je i mirë, apo jo?"
Dhe Noeli iu përgjigj:
"E keni fjalën, moralisht apo intelektualisht?"
Maurice Cowling mendoi se ishte një përgjigje e zgjuar ajo që i dha Noeli, dhe kështu e fitoi bursën në "Peterhouse" dhei vazhduam studimet atje.

**4.- Harry Eyres**

Ne ishim në shkollë së bashku në kolegjin "Eton", në fakt, në shtëpinë e studiuesve. Të dy ishim studiues të Kolegjit të Mbretit. Ai ishte përpara meje. E kujtoj shumë mirë, sepse ishim vetëm 70 prej nesh që jetonim së bashku në ndërtesat e vjetra në Eton. Noeli ishte një njeri që nuk mund ta harrosh dhe ne të gjithë ishim të dhënë pas tij. Pra, ai dalloi dhe ishte i jashtëzakonshëm, edhe atëherë.
Por kam edhe kujtime të tjera prej tij, madje edhe duke luajtur futboll. I pëlqente të ishte sulmues i majtë. Më kujtohet edhe sot, në fushën e futbollit.

Gjithashtu, ai është muzikant i kompletuar, siç e dini, pasi ka shkruar një libër të shkëlqyer për George Enescu-n, dhe ka luajtur në piano. Më kujtohet që ai luante Shopenin dhe isha shumë i impresionuar. Edhe unë luaja gjithashtu në piano, por jo aq mirë sa ai.
Ai u dëshmua se ishte një njeri mjaft i jashtëzakonshëm, si dijetar por edhe si humanist gjithaq.

**5. – Prof. David Abulafia**

Noel Malcolm ishte student i shkëlqyeshëm në Cambridge, vetëm pak vite pasi unë isha bërë anëtar i Kolegjit. Ai u intervistua nga një filozof politik shumë i famshëm, i quajtur Michael Oakeshott. Unë jam dëshmitar i kësaj, pasi isha në këshillin e kolegjit, me të drejtën të vendosja nëse do ta zgjidhnim atë apo jo. Performanca e tij ishte një *Tour de Force*. Ne e zgjodhëm atë menjëherë, i ofruam të ndiqte kolegjin dhe kështu ai erdhi këtu dhe pati një sukses shumë të madh.
Ai publikoi një libër të quajtur *Dei Dominis*, kushtuar një intelektuali kroat të shekullit XVII-XVIII. Po ashtu, ai botoi një libër për muzikantin rumun Enescu. Kjo është ajo që tregon tashmë vargun e jashtëzakonshëm të interesave të tij, në atë periudhë të caktuar.

**6.- Alda Dizdari**

Njohja ime me Sir Noel Malcolm është e lidhur ngushtë me kompozitorin rumun George Enescu. Në vitin 2008, unë kisha debutin tim në sallën prestigjoze "Wigmor Hall", në Londër dhe një ndër pjesët në program ishte Sonata për violinë dhe piano numër 3, në karakter popullor rumun, e George Enescu -t. Nuk e dija që atë natë në sallë kisha Sir Noel Malcolm, i cili erdhi pas koncertit të më uronte dhe foli në një shqipe të kulluar, me theks verior, gegë. Dhe në atë moment u bë ajo lidhje e fortë, ku jo vetëm u habita, pasi ky ishte Sir Noel Malcolm që ka shkruar librin më të rëndësishëm për jetën dhe veprën e kompozitorit, dirigjentit, pedagogut të madh rumun, George Enescu. Ky libër është aq i rëndësishëm për botën britanike, sa në çdo program salle ku luhet muzika e George Enescu-t gjithmonë citohet ose paragraf, ose mendime, ose detaje nga libri që ka shkruar Sir Noel Malcolm. Kjo tregon që njohuria e tij për veprën e këtij gjiganti të shekullit XX është jashtëzakonisht e thellë, është jashtëzakonisht e detajuar, dhe mund të them, sepse tani e konsideroj Sir Noel Malcolm një mik, se ai është jo vetëm një njohës shumë i mirë i muzikës së George Enescu-t, por ai është njjohës jashtëzakonisht i mirë i muzikës klasike. Vetë ka luajtur instrumentin e violës dhe është i apasionuar pas muzikës klasike, por është, për mendimin tim, një mendimtar shumë i madh, me hije jashtëzakonisht të rafinuar.

**7. Prof. David Abulafia**

Por ambicia e tij e madhe ishte të redaktonte veprën më të madhe të Thomas Hobbes, LEVIATHAN – IN" e tij, veprën e filozofisë politike për të cilën ekzistonin shumë botime, por nuk ishin sa duhet të arrira.

**8.- Bejtullah Destani**

Është një rast shumë i rrallë që përveç Historisë së Bosnjës, Historisë së Kosovës, biografisë së një prifti katolik kroat, i cili ka jetuar në shekullin e shtatëmbëdhjetë, Noel Malcolm njihet si ekspert botëror për Thomas Hobbes. Për letrat e Thomas Hobbes–it, - janë 1.200 faqe letra, në dy vëllime, të botuara nga Oxford University Press, - ai ka punuar afro 12 vjet.
Të gjitha letrat janë përkthyer nga latinishtja në gjuhën angleze. Janë letra, domethënë të gjitha, të botuara, sepse deri tani nuk kanë qenë të botuara ndonjëherë kanë qenë pjesërisht, pak letra. Malcolm i ka marrë dhe i ka përkthyer të gjitha letrat dhe i ka botuar në një vëllim të veçantë. Përveç kësaj, ai ka botuar një libër tjetër "Aspects of Hobbes". Është një lloj biografie, dhe me një titull shumë, tepër modest. Sipas recenzentëve dhe kritikave të shtypit britanik, akademik, tregojnë se ka bërë një punë të jashtëzakonshme, por titullin e librit e ka vënë me një modesti shumë, shumë të rrallë. Domethënë, "Aspects of Hobbes" është një biografi gati e përkryer për jetën dhe veprimtarinë shkencore të filozofit të madh anglez Thomas Hobbes. Mbas kësaj, ka punuar afro 30 vite për të gjithë veprën e Thomas Hobbes – it, që e ka përkthyer nga latinishtja në anglisht. Janë katërmijë faqe. Ai ka bërë edhe nja dy libra të tjerë, të një filozofi anglez që ka qenë një matematikan, filozof.
Me këto, Hobbes–in katër mijë faqe, që prapë e ka botuar Oxford University Press, Noel Malcolm si përfundim, ishte një prej personave shumë të rrallë në Historinë e Mbretërisë së Bashkuar, që ka marrë titullin "Sir", falë punës për studimet mbi Hobbes, studimet për Kosovën e Bosnjën dhe kontributin e tij për gazetarinë në shtypin britanik dhe edhe si gazetar komentator politik.

**9. - Lord Charles Moore**

Më pas, me vazhdimin e viteve 1980, unë në këtë kohë redaktoja revistën "The Spectator", e cila e ktheu si aspektin kryesor të vetin mbulimin për Europën Lindore, Europën Jugore dhe Europën Qendrore.

Të gjitha ato pjesë të Europës që dominoheshin nga një pjesë e Bllokut Sovjetik, të gjitha ishin diktatura komuniste, ndonëse, natyrisht, Shqipëria kishte të veçantën e saj.

Mendoj se historia, motoja, slogani i përdorur: "Shqipëria dhe Kina e fortë 700 milionëshe", më argëtonte gjithmonë. Ne ishim shumë të prirur për "The Spectator", të hapeshim ndaj lexuesve tanë për të kuptuar se çfarë po ndodhte, pasi Lufta e Ftohtë po zhvillohej në vende si Polonia.

Noeli shte shumë i dobishëm për këtë, në radhë të parë. Mendoj se vendi i parë ku ai u përfshi realisht me këtë, për sa na përket neve në "The Spectator", ishte Rumania, ku ai e mësoi rumanishten.

Ai dinte shumë për Rumaninë. Ai shkoi në Rumani nën Çausheskun dhe shkroi një biografi të Enescu-t, kompozitorit rumun, dhe ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në lidhje me këtë.

Përafërsisht në të njëjtën kohë, nuk jam i sigurtë për datën, i kërkova Noelit të bëhej korrespondent politik i "The Spectator", që nuk është realisht një detyrë thjesht raportuesi, por roli i një analisti.

**10. - Harry Eyres**

Pra, ai ishte në të vërtetë një gazetar politik dhe kjo mendoj se është e rëndësishme, megjithëse ai është padyshim një studiues jashtëzakonisht i shquar, një prej më të dalluarve në pesëdhjetë apo njëqind vitet e fundit. Ai është rast krejt përjashtimor.

Unë do të thosha se si njeri krejt i pazakonshëm, ai nuk është vetëm një studiues, por gjithashtu edhe një njeri që i pëlqen të shkruajë, që mendon për lexuesin e zakonshëm, jo vetëm për akademikët dhe specialistët. Ai nuk e fsheh këtë në asnjë nga librat, që i ka shkruar për lexuesin e zakonshëm. Është një kombinim përjashtimor.

Pa dyshim që ai është një linguist i pakrahasueshëm, krejt befasues. Unë mendoj se ai është në fakt një lloj POLIMATËSI, edhe pse kjo fjalë është e kufizuar, pasi nuk ka shumë të tjerë. Por Noeli është sigurisht njëri prej tyre. Edhe po të përmendim librin për Enescu-n dhe shumë studiues, por pa dyshim ai njihet më së shumti si studiuesi më autoritar dhe kryesori i Thomas Hobbes, ndonëse ka shkruar edhe për shumë gjëra të tjera.
Por përtej kësaj, ka diçka tjetër që më bën përshtypje tek ai: ka një angazhim të fortë moral kur shkruan, veçanërisht për Ballkanin. Kështu që, unë mendoj se kur ai shkruan këto libra për Bosnjën dhe Kosovën, është i mbingarkuar jo vetëm prej studimeve, por edhe prej luftërave të tmerrshme në ish-Jugosllavi.

**11.- Dr. Rudina Jasini**

Kur kam arritur në Universitetin e Oksfordit, unë kam patur privilegjin të takoja Sir Noel Malcolm, sikundër edhe disa studentë të tjerë shqiptarë, edhe shqiptarë të Kosovës. Madje ka pasur këtu edhe një shoqatë të studentëve shqiptarë, në Universitetin e Oksfordit. Dhe në kuadër të veprimtarisë së shoqatës, ne jemi takuar disa herë.

Të ndriçosh një mendim lidhur me veprimtarinë por edhe me personalitetin e Sir Noel Malcolm, nuk është e lehtë, sepse këtu kemi të bëjmë me nje individ i cili është euridit, një dijetar i kapaciteteve dhe përmasave ndërkombëtare.

Jo vetëm për veprimtarinë dhe hulumtimin akademik dhe librat qe ai ka shkruar lidhur me çështjen e Kosoves, por edhe më gjerë të shqiptarisë, siç e quajmë ne.

Unë mendoj se Noel Malcom ka një vlerë të jashtëzakonshme si dijetar ndërkombëtar.

Siç mund ta dini, ai është i specializuar si hulumtuesi mbase më autoritativ, më i njohur për sa i përket Thomas Hobbes - it. Për të gjitha aktivitetet e tjera, të cilat neve na duken si *hobby*, pasi kemi të bëjmë me një individ i cili flet mbi 23 gjuhë të huaja dhe mbi të gjitha, që ka një kuriozitet intelektual. Pra, nëse do të pyesnim se çfarë e motivon Sir Noel Malcom të hulumtojë lidhur me çështjet e Shqipërisë, si në aspektin historik, publicistikës, linguistikës, ajo që në të vërtetë të bën të mendosh: Përse vallë Shqipëria?, ndërkohë që është privilegj për ne, është se ai ka atë kuriozitetin intelektual. Atë e ngacmon diçka lidhur me identitetin shqiptar.

**12. – Prof. David Abulafia**

Ai redaktoi letrat e Thomas Hobbes-it, si edhe përkthimin nga Hobbes-i të veprës së historianit të madh grek Thucydides, i cili ishte shumë interesant vetëm për të parë se si reagoi Hobbes ndaj një prej teksteve të mëdha të historisë, të politikës greke, në antikitet. Pra, ai po bënte shumë detyra jashtëzakonisht të vlefshme në atë kohë. Kjo mendoj se doli në dritë në vitin 2001, kur ai u zgjodh anëtar i Akademisë Britanike dhe në Akademinë Kombëtare për shkencat humane dhe shoqërore, gjë e cila për një akademik është një nga nderimet më të larta që njeriu mund të gëzojë në këtë vend, dhe Akademinë Kombëtare për shkencat sociale dhe humanitare.

**13. – Prof. Rexhep Ismajli**

Noel Malcolm ka qenë i pranishëm në Ballkan me veprat e tij të njohura, që i ka nxjerrë në momentin kur ishte kriza: librin për Bosnjën, i cili ishte libri që luajti një rol të

rëndësishëm edhe për fatet e Bosnjës dhe librin për Kosovën, që po kështu ishte një libër i shkruar në momentin e duhur për një çështje shumë akute ndërkombëtare në tërë botën e atëhershme, në Europë po se po, dhe një çështje që për ne ishte shumë e madhe.
Ishim në valën e krizës, lufta tashmë kishte filluar. Ishte fushata e madhe e dëbimit të popullatës etj.
Dhe natyrisht, pas luftës, në vitin 2004 e kemi zgjedhur Anëtar të Jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me unanimitet të plotë, me vlerësimin më të lartë të mundshëm për shkak se ka bërë një libër me të cilin as ka pasur nevojë që t'ia mbajë anën askujt, as neve dhe as serbëve. Por ka shpërfaqur një realitet historik, dhe e ka bërë në një kohë kur ka qenë shumë e nevojshme.
Unë dua të them për atë libër se, cilësia e parë e tij është dokumentimi, dokumentimi shumë i ndier.

**14.- Prof. Lea Ypi.**

Takimi im i parë me Noelin është i çuditshëm dhe interesant, sepse unë dija për punën e dikujt që quhej Noel Malcolm, një studiues i jashtëzakonshëm i Hobbes-it, nga i cili kisha lexuar artikuj të ndryshëm rreth teorisë së shtetit modern, marrëdhëniet midis Hobbes-it dhe Spinozës, çështjet e sovranitetit, dhe kisha dëgjuar për Noel Malcolm-in si një nga eksponentët më të spikatur të studimeve të historisë filozofike moderne.

Gjithashtu kisha dëgjuar edhe për një Noel Malcolm që shkruante për Kosovën, për Bosnjën, që interesohej për çështjen shqiptare etj., dhe deri ditën që jam takuar me Noelin, nuk e dija që ky ishte i njëjti person.

Mbaj mend që takimi im i parë me Noelin ka qenë kur kam shkuar në Oxford për të filluar një post-doktoraturë, pasi kisha mbaruar studimet e mia doktorale në Itali dhe isha transferuar në Oxford.

Aty mora një *e-mail* nga Noel Malcolm, i cili më thoshte se "kam marrë vesh që je shqiptare dhe që po bën post - doktoratë në Kolegjin në Oxford".

Dhe me atë modestinë që e karakterizon Noelin, ai po prezantonte veten, ndërkohë që natyrisht, unë e njihja veprën e tij dhe në fakt dija edhe veprat e këtyre "dy Noel-ëve". U lidhëm, u takuam, dhe ai takim ka qenë shumë i rëndësishëm për mua edhe nga ana personale, pasi më prezantoi me shokë dhe shoqe, të cilët për mua u bënë shumë të rëndësishëm më pas, në vijim të jetës time në Angli.

Kjo ishte për mua e jashtëzokonëhme, kur zbulova që ky Noel Malcolm që studionte Hobbes-in dhe për të cilin unë kisha një admirim të pakufizuar dhe Noel Malcolm-i që dija se shkruante për Shqipërinë, që kishte shkruar Historinë e Kosovës, ishin i njëjti person.

Sepse më dukej, mendja ime nuk arrinte ta kapte se si ka mundësi që një njeri të shkruajë me kaq kujdes, me kaq detaje, me kaq thellësi, me kaq erudicion, për çështje kaq të ndryshme nga njëra-tjetra.

Filozofi modern, zakonisht, në qoftë se merret me Hobbes-in, merret vetëm me Hobbes-in, gjatë gjithë jetës.

Dhe në Angli ka studiues shumë të rëndësishëm të Hobbes-it, që e kanë atë vetëm njërën nga ato shtyllat e kërkimit të tyre.

Dhe për mua ishte e jashtëzakonshme se si mundej të ishte ky i njëjti njeri. Dhe pastaj, kur u njoha me Noelin, ishte akoma edhe më e jashtëzakonshme, pasi Noeli është një njeri aq modest dhe aq i kujdesshëm dhe aq i kursyer në fjalë për punën e tij, saqë unë vetëm e pyesja për të kuptuar se si ka mundësi dhe si lidheshin këto të dyja.

**15. Robert Wilton**

Për mua, aspekti që më prek më së shumti është një farë paradoksi në karakterin e tij, ose në imazhin e tij si figurë akademike. Unë e njoh si vigan, si gjigant i studiuesve jo vetëm të Ballkanit, por të Mesjetës. Ai i ka arritur majat akademike, sipas standardeve botërore. Gjithsesi ai ka një aspekt, një pamje të madhe, por në të njejtën kohë kam pasur kënaqësinë të njihem me të, nuk pretendoj ngushtë, por jemi takuar disa herë.
Ai është njeri me aq shumë kortezi, xhentilesë, politesë, tepër i kultivuar, shumë i qetë, shumë i tërhequr.
Edhe madhësia e tij mendore kundërshtohet krejt me karakterin e tij personal aq të lehtë, aq të civilizuar. Unë do të prisja një figurë tepër arrogante, tepër të fryrë.
Ai është e kundërta.
Ai, me çdo element madhësie më të lartë, është bërë me më shumë kortezi, përulje.
Ai është një njeri, mbi të gjitha, i civilizuar.
Kështu edhe kur pata mundësinë ta takoja për herën e parë, kjo më prekte më shumë.

**16.- Dr. Daut Dauti**

Roli i Malcolm-it është i madh në të gjitha aspektet, duke patur parasysh se ai një kohë të gjatë ka ushtruar ndikim edhe si kolumnist, me artikujt e tij në *Spectator, Daily Telegraph* etj., po sidomos e mbajmë mend Noel-in për qëndrimin korrekt që kishte gjatë luftës, me paraqitjet e tij në televizionet britanike këtu, apo edhe me artikujt gjithandej në shtypin britanik, e madje edhe në atë amerikan apo anglofon më gjerë. Domethënë, roli i tij ka qenë shumë i madh dhe për fat të mirë, ende është i tillë saqë influenca e tij vazhdon të veprojë dhe kjo nuk ka ndryshuar vetëm çështjen shqiptare dhe politikën e jashtme të

Britanisë së Madhe, por unë besoj se kjo ka sjellë një ndryshim edhe në Ballkan në përgjithësi, për arsye se Noel Malcolm është autor edhe i librit për Historinë e Bosnjës. Kështu që, ai është i njohur edhe për faktin se ka sjellë një ndryshim, një pasqyrë të së kaluarës së popujve të Ballkanit. Ai ka shkruar për historinë e shqiptarëve dhe të boshnjakëve në dy librat e tij, por kur flet për shqiptarët dhe boshnjakët në Ballkan, njëkohësisht ke folur edhe për serbët, grekët dhe popujt e tjerë. Kështu që, dua të them shkurtimisht se roli i tij në histori është jashtëzakonisht i madh, pasi ka sjellë ndryshime të mëdha dhe objektive.

**17.- Prof. David Abulafia**

Gjuhët e shumta që ai përdor janë diçka që ne të gjithë do ta kishim zili, dua të them shqip, rumanisht e kështu me radhë, së bashku padyshim me gjuhët e Europës Perëndimore, të cilat luajnë një rol të madh edhe në atë libër. Pra ky është një njeri që ka aftësinë aq të nevojshme me gjuhët, të cilat gjithmonë kanë qenë pengesë për studimin e asaj pjese të botës.
Studiuesit në Perëndim, duke veçuar Shkollën e Studimeve të Europës Lindore, që është pjesë e Universitetit të Londrës, në fakt mendoj se kanë shumë pak ekspertizë me gjuhët e Europës Lindore, siç u vu re me rënien e komunizmit.
Atëherë ne zbuluam se për një numër të madh vendesh, që nga Estonia deri në Shqipëri, ata thjesht nuk ishin në gjendje vërtet si studiues që t'i përdornin ato gjuhë. Në këtë kuptim, Noeli është krejt i jashtëzakonshëm.

**18.- Dr. McDonagh**

Më lejo të them se si gjuhëtar ai ishte në gjendje të kapërcente të gjitha pengesat që dalin midis gazetarit normal dhe njerëzve të tjerë, për të cilët po shkruajnë.
Pra, gazetarët normalë shkojnë në vende ku nuk e flasin gjuhën, nuk i njohin njerëzit e tjerë, kështu që atyre iu duhet të kenë përkthyes, iu duhet të kenë shofer. Noeli mund të flasë drejtpërdrejt me njerëzit për të cilët ka vajtur dhe me të cilët bisedon.
Dhe duke mos e pasur atë pengesë gjuhësore, ai merr njohuri shumë më të qarta dhe më të vërteta për njerëzit që takon. Kjo aftësi gjuhësore e tij është sa mahnitëse, aq edhe e jashtëzakonshme.
Unë nuk e di saktësisht sa gjuhë flet, veçanërisht tani që në ish-Jugosllavi kemi rreth 5 gjuhë që përdoren, nga vetëm një, që ishte ajo serbo-kroate.

E kam parë një herë kur ishim në Shqipëri, tek fliste me disa vllehë në një fshat malor.
Nuk kisha takuar kurrë dikë që fliste vllahisht. Në fakt, kurrë nuk kam rastisur të takoj ndonjë vllah. Por Noeli qe në gjendje të bisedonte me ta për çmimin e deleve apo çfarëdo

teme që kishte biseda në ato çaste. Dhe ishte vërtet një mrekulli të shikoje se sa të lumtur ishin ata njerëz që po takonin një të huaj, i cili iu fliste drejtpërdrejti në gjuhën e tyre të rrallë. Atij i pëlqente të fliste me ta. Aty kuptova se ajo që arrin të bëjë Noeli, ka një aspekt shumë të ndryshëm nga ata që punojnë gjatë gjithë kohës me ndihmën e përkthyesve.
Në të vërtetë, shumë nga librat e tij janë shkruar në bazë të burimeve parësore, ndërsa burimet dytësore janë në anglisht.

**19.- Lord Charles Moore**

Interesimi i tij për Ballkanin është shumë i madh dhe kjo pjesërisht buron nga interesi shumë i lartë, sa edhe aftësia e jashtëzakonshme për të mësuar gjuhë të huaja.

Pra, kur ai ishte i ri, mësonte një gjuhë çdo vit, dhe unë e besoj se ishte kështu. Ai më thoshte se mënyra më e mirë për të mësuar gjuhët ishte thjesht të lexoje një libër për secilën gjuhë, me vetë metodat e mësimit të saj.

Librat ishin një nga ata "Gjuha pa mësues", dhe më pas duhet ta ushtrosh. Pra, ai e bëri këtë edhe me gjuhën galike, gjuhën që e flasin në ishujt e largët të Skocisë, e cila është jashtëzakonisht e vështirë. Ai e bëri atë me të gjitha llojet e gjuhëve shumë më të zakonshme, si spanjishtja apo gjermanishtja, apo çfarëdo gjuhe tjetër.

Me kalimin e viteve, mendoj se Noeli ndoshta mund të flasë më shumë se 20 gjuhë.

**20. - Bejtullah Destani**

Ai bëri hulumtime nëpër arkivat europiane edhe kishte një bibliotekë të jashtëzakonshme, ndoshta bibliotekën më të pasur që kam parë nga një person privat, që ka për historinë jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të të gjithë Ballkanit. Por natyrisht fokusi kryesor ishte historia e shqiptarëve, dhe sidomos historia e Shqipërisë. Kishte do libra të rrallë, të jashtëzakonshëm që, në vlerë, ai kishte paguar një libër, më kujtohet një gramatikë, afro 5.000 pound. Kishte kopje origjinale të Barletit, kishte një libër të Bogdanit, kishte, domethënë është i pasionuar pas librave të vjetër jashtëzakonisht, për shumë vite. Kishte të gjithë librat e Edith Durham-it, të Aubrey Herbert. Domethënë, bashkëpunimi me Noel Malcolm ishte shumë, në mënyrë jashtëzakonisht profesionale, edhe ishte, për mendimin tim, një krenari shumë e madhe që unë e pata atë mundësi që të bashkëpunoja.

**21.- Edith Harxhi**

Unë jam njohur me profesor Noel Malcolm-in dhe me shkrimet e tij, gjatë periudhës që isha studente në Universitetin e Edinburgut, për shkenca politike.

Unë isha shumë e re në atë kohë kur u njoha me shkrimet e profesor Malcolm-it, por edhe të profesor Mark Almond, një historian, një profesor tjetër shumë i zoti të cilin e takova pas shumë vitesh në Universitetin e Bilkentit, ku ai ishte profesor i Historisë Politike dhe unë po bëja doktoraturën.

Natyrisht, që në fillimet e para të miat në fushën e politikës, si akadamike fillmisht, si shkollare dhe më pas si diplomate, njohja me shkrimet e profesor Noel Malcolm dhe profesorëve të tjerë ishte një inkurajim shumë i madh për një vajzë të re e cila vinte nga Lindja, por edhe për të gjithë lëvizjen tonë antikomuniste në përgjithësi.

Që atëherë ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në atë që u formësua si Lëvizja Demokratike në Shqipëri, dhe në gjithë vendet e Lindjes.

**22.- Harry Eyres**

Unë e shoh Noelin, në një farë mënyre, si një figurë mjaft romantike. Në fakt, unë nuk e di fare përgjigjen për këtë, por supozoj se ai duhet t'i dojë vërtet ato rajone dhe ai është padyshim i magjepsur nga Shqipëria dhe gjithçka që ka të bëjë me të.

Ai ka udhëtuar gjithashtu në të gjithë atë që dikur quhej Europa Lindore. Një herë udhëtova bashkë me të në Rumani, në Transilvani, për të vizituar kishat e vjetra saksone, të cilat janë shembuj të jashtëzakonshëm të arkitekturës mesjetare në këto fshatra saksone, që janë disi nën kërcënim.

Noel merrej me një organizatë që po përpiqej të shpëtonte arkitekturën atje. Por po, sigurisht, ai flet rumanishten, i flet të gjitha këto gjuhë dhe më tha se për rreth dy muaj ose diçka të tillë, do të mësonte hungarisht, e cila është një gjuhë tmerrësisht e vështirë. Ishte mjaft e jashtëzakonshme.

Por unë supozoj se ai thjesht e do atë pjesë të botës dhe se nuk është i pari anglez, pa dyshim romantik, që bie në dashuri me Ballkanin.

Ka pasur edhe të tjerë që i kanë dhënë një pjesë të jetës së tyre. Këtu mund të përmend, megjithëse kjo mund të tingëllojë pak si jo modeste, stërgjyshin tim, Sir Harry Charles Augustus, emrin e të cilit e trashëgoj unë. Ai shërbeu si ambasador i Britanisë në Shqipëri në vitet 1920 dhe padyshim ishte gjithashtu shumë i shqetësuar dhe i interesuar për këtë vend, dhe mendoj se ishte një nga ata njerëz që shpresonte ta sillte Shqipërinë në një të ardhme më të begatë dhe moderne.

**23. – Prof. David Abulafia**

Mendoj se nuk ka dyshim që ai është një nga historianët më të dalluar në këtë vend.

**24. - Dr. David Shankland**

Me pak fjalë, mendoj se Noeli është më i afërti që ne kemi me një gjeni në studimet historike moderne, në këtë moment.
Ai është një studiues fantastik dhe unë kam qenë gjithmonë absolutisht i lumtur që njihem me të personalisht.
Aftësia e tij si historian është e jashtëzakonshme, jo thjesht për rrjedhshmërinë e tij të madhe në shumë gjuhë të ndryshme, por edhe sepse kur don të hetojë një pjesë të historisë, ai shkon gjithmonë në arkiva, ai gjithmonë përpiqet të punojë aty ku janë faktet.
Dihet se është në modë në këto kohë, të thuash ndonjëherë se faktet nuk ekzistojnë. Sigurisht që kjo është e pakuptimtë. Noeli është absolutisht i mrekullueshëm kur vjen puna për të kuptuar se çfarë do të thotë të jesh i saktë, në këtë rast, të gjesh se çfarë ndodhi në të vërtetë, kush jetoi atje, çfarë bënë ata, çfarë ngjarjesh ndodhën.
Pikërisht në këto fusha, ai është absolutisht i mrekullueshëm.
Dhe pastaj, ai i bashkon këto fakte të ndryshme në një rrëfim që është plotësisht bindës. Për shembull, libri i tij "Kosova, një histori e shkurtër" është një shembull i shkëlqyer se si kjo mund të bëhet në një libër që meriton të vlerësohet si i famshëm.

**25.- Mal Berisha**

Episodin e parë të këtij cikli dokumentarësh kushtuar Sir Noel Malcolm e mbyllim me fjalët e studiuesit të famshëm, Dr. David Shankland, Drejtor i Institutit të Antropologjisë në Britaninë e Madhe.

Ai sapo tha se Sir Noel Malcolm është më i afërti me një gjeni, dhe në të vërtetë, ne e konsiderojmë të tillë. Jo vetëm për veprën e tij të jashtëzakonshme lidhur me filozofët anglezë, vepra, të cilat kërkojnë studiues të rangut të Harvard, Oxford dhe Cambridge, por me veprën që ai ka bërë për ne shqiptarët - “Kosova, një Histori e Shkurtër”.

Kjo vepër, në fakt është e bazuar në dokumente shumë, shumë autentike, dhe sjell përpara nesh jo vetëm ngjarjet e fundit të shekullit të 20-të ose të fillimit të shekullit të 21-të. Më shumë se aq, ajo sjell përpjekjet që kombi shqiptar ka bërë për të mbijetuar dhe për të shpëtuar, jo vetëm nga zgjedha turke, por edhe nga lakmitë e fqinjëve të cilët të mbështetur nga fuqitë e mëdha të kohës, ishin gati ta copëtonin Shqipërinë dhe ta ktheninin në një plasdarmë të fuqive të tjera.

Në këtë aspekt, vepra e Sir Noel Malcolm – t është një vepër e jashtëzakonshme, e cila do të shtjellohet në episodin e dytë të këtij cikli.

Dhe, për ta lidhur me historinë ose me ngjarjen më të rëndësishme të shqiptarëve të shekullit XIX, që është ajo e Lidhjes së Prizrenit e vitit 1878, erdha që ta fillojmë pikërisht këtu…

**EPISODI I DYTË**

**KOSOVA – NJË HISTORI E SHKURTËR**
**DHE NDIKIMI QË KA PATUR NË VENDIM - MARRJEN E UDHËHEQËSVE PERËNDIMORË PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS**







Gazeta "THE NEW YORK TIMES"

"*Kosova, Një Histori e Shkurtër* është një vepër magjistrale e historisë, e hulumtuar dhe e argumentuar shkëlqyeshëm.
Ky libër do të merret në mënyrë të pashmangshme si një kontribut jashtëzakonisht i vlefshëm për të kuptuarin dhe njohuritë tona rreth një krize bashkëkohore.
Ky libër është udhëzuesi më i mirë deri më sot, i vënë në dispozicion për hapat që duhen marrë ndaj një katastrofe fatale."

**26.- Mal Berisha**

Veprimtaria shkencore, publicistike e Sir Noel Malcolm - t është paraqitur nga shumë mjete prestigjioze të medias ndërkombëtare.

Padyshim, edhe mediat shqiptare, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, nuk kanë reshtur së paraqituri veprën e tij.

Duket se asnjëherë nuk është e mjaftueshme të flasim për këtë figurë kaq të ndritur, i cili me veprën e tij i ka bërë kaq shumë nder çështjes shqiptare.

Pikërisht për këtë në shkuam në Universitetin Oxford, në mjediset e "All Soul College", aty ku studion, punon dhe prodhon veprat e tij, Sir Noel Malcolm dhe iu adresuam atij me pyetjen e thjeshtë:
Si lindi interesi Juaj dhe zelli kaq i madh për historinë e kombit shqiptar?

**27.- Sir Noel Malcolm**

Më duhet të them që në fillim se kërkoj falje, pasi do të flas vetëm në anglisht.

Problemi është se nuk mund ta shpreh plotësisht mendimin tim në gjuhën shqipe. Lexoj shumë, por rrallë flas shqip.

Është një histori e vjetër, që kur isha student në Cambridge në vitet 1970, dhe fillova të interesohem për rajonin e Ballkanit në Europë. Unë dëshiroja të shkoja për pushime verore dhe të udhëtoja. Më pëlqente të ecja nëpër male, pasi atje gjenden peizazhe të hijshme në malet e larta. Ky lloj udhëtimi, nëse keni qenë student me shumë pak para, është jashtëzakonisht ekonomik.

Do të ecja nëpër male dhe do të më ftonin njerëzit nëpër shtëpitë e tyre në fshatrat malore dhe të përjetoja mikpritjen e tyre të mrekullueshme. Por, kur udhëton kështu, duhet të flasësh gjuhën. Për këtë, kishte laboratorë gjuhësorë në Cambridge, ku thjesht mund të shkoje dhe të merrje një kurs me kaseta dhe thjesht e krejt i pavarur, nëse do të kishe disa orë të lira, do të uleshe dhe do të studioje. Kështu, mbi këtë bazë, fillova të mësoj një gjuhë të re çdo vit. Dhe pastaj, në verë, shkoja atje për aq kohë sa të mundja, për të ecur e për të udhëtuar e kështu me radhë.

Kështu, në një vit mësova greqishten moderne, vitin tjetër rumanishten, pastaj serbo-kroatishten dhe një vit më vonë edhe turqishten. Dhe gradualisht po e plotësoja hartën gjuhësore të Ballkanit. Por ishte një gjuhë që nuk mund ta mësoja me atë metodë, sepse aty nuk kishte asnjë kurs në dispozicion. Dhe kjo ishte gjuha shqipe.

Mua më intrigoi kjo lloj gjuhe dhe njerëzit, me të cilët ishte më e vështirë të njihesha. Dhe së fundi, gjeta në bibliotekën e universitetit një libër të vjetër me titull "Shqipja pa mësues", dhe fillova ta mësoj. Në atë kohë, padyshim që mund të udhëtoja në Kosovë, megjithëse serbishtja ime ishte më e mirë se shqipja, por askush nuk priste që unë të flisja shqip.

Prapëseprapë, unë nuk mund të udhëtoja i pavarur në Shqipërinë komuniste. Kjo ishte padyshim e pamundur. Vetëm pas rënies së komunizmit në vitin 1992, arrita të shkoja në Shqipëri për herë të parë.

Kisha njohuri të thjeshta të gjuhës shqipe. Por, pasi kisha punuar seriozisht për historinë dhe kulturën e Ballkanit, kjo ishte pjesa e mbetur të cilën doja ta plotësoja. Dhe kështu, fillova të lexoja më shumë për historinë shqiptare, ndaj interesimi im për të u shtua edhe më shumë.

**28. - Bejtullah Destani**

Me Sir Noel Malcolm jam takuar për herë të parë në fillim të vitit 1994. Ishte një konferencë antropologjike në Universitetin e Londrës.

Aty erdhi dhe i kisha ca fotokopje, ca letra të Edith Durham-it, që i kisha gjetur në Arkivin kombëtar të Britanisë së Madhe, në "Kew Gardens". Prej aty filloi një bashkëpunim. Na ftoi në promovimin e librit të letrave të Thomas Hobbes-it.

Por para meje, e kishte takuar Noel Malcolmin, në promovimin e librit për Bosnjën, një miku im nga Kosova, që kishte qenë drejtor i Zyrës së Kosovës. Isa Zymberi i kishte thënë Noel Malcolm – it: "A mund ta shkruash një libër për Kosovën, historinë e shkurtër të Kosovës?"

Dhe ashtu ndodhi!

**29.- Isa Zymberi**

E kam takuar, atëherë quhej Noel Malcolm, tash është Sir Noel Malcolm, pasi që është kalorësuar më vonë, për të cilin sapo e takova, më thanë se është historian dhe gazetar politik, por e njeh gjuhën shqipe shumë mirë. Pra ky ka qenë takimi im i parë me Sir Noel Malcolm, diku nga marsi i vitit 1992.

Ai që nga fillimi ka qenë përkrahës i çështjes së Kosovës, dhe ka marrë pjesë në çdo aktivitet që kemi organizuar, por edhe në çdo tryezë të rrumbullakët apo konferencë, është shprehur në favorin tonë. Ma vonë, siç e dimë, ai shkruajti librin "Bosnja, një histori e shkurtër". Kjo ndodhi në vitin 1994. Fill pas publikimit të këtij libri, ndodhi që në një prej protestave që organizonim rregullisht në "Trafalgar Square", ta takoj Noelin. Noelit i thashë: Çka mendon, a mund ta bësh të njejtën gjë për Kosovën? Ai u mendua pak dhe më tha:

"E kam shume të vështirë, sepse është një mal shkrimesh që kanë bërë serbët, historianët serbë, edhe pse shumica e tyre nuk vlejnë gjë, por për ta shkruar librin duhet ta kaloj gjithë këtë literaturë, është shumë e vështirë."

Unë i thashë: besoj se je ndër ata që mund ta tejkalosh këtë vështirësi. Dhe e kemi lënë me aq. Tri javë më vonë, më telefonoi në zyrë dhe më tha:

"Kam vendosur ta shkruaj librin, por të lutem mos e bëj publike sepse nuk i kam thënë askujt."

**30. - Bejtullah Destani,**

Në vitin 1995, unë dhe Nehat Islami, si gazetarët e parë shqiptarë morëm një intervistë nga Noel Malcolm, për gazetën "Bujku" dhe "Rilindja", e cila botohej ende jashtë vendit. Ai na kërkoi që të mos e përmendim fjalën "historia e Kosovës" që po shkruante, sepse tha: "Serbët kanë mjete të mjaftueshme për të bllokuar punën dhe për të anulluar kontratën me shtëpinë botuese".
Dhe kështu ndodhi. Ne nuk e përmendëm kurrë.

**31 - Isa Zymberi**

Libri ka dalë në vitin 1998. Në qoftë se libri për Bosnjën ishte shumë me rëndësi, ai u botua pak a shumë vonë, sepse Bosnja në atë kohë ishte pothuajse e shkatërruar. Ndërsa libri që doli për Kosovën u botua në kohën kur ma së shumti nevojitej, që të nxitej komuniteti ndërkombëtar të ndërmerrte diçka për Kosovën.

**32. - Dr. Melanie McDonagh**

Është një kënaqësi ta lexosh, madje të bën ta lexosh për argëtim librin e tij. Ai çmontoi kaq shumë paragjykime dhe keqkuptime me veprën e tij.

Për shembull, siç del gjatë leximit, ai flet për Kosovën mesjetare para Princit Llazar, para Betejës së Kosovës.

Ai përmbys një sërë paragjykimesh dhe më pas në adresimin e vetë betejës, për kompleksitetin e të gjithë çështjes dhe se si, në fakt, nuk është e qartë përse grupe të ndryshme u angazhuan në të dyja anët e saj.

Ai ka bërë një punë të madhe, thjesht për të fshirë disa nga hamendjet absolute të paraqitura nga shumë akademikë në rajon. Në librin për Bosnjën, ai zbërthen të gjithë konceptin e Ballkanit mbi kishën, të cilin të gjithë e kishin marrë si Ungjill, për breza më

parë. Dhe kjo është pranuar nga një numër i madh politikanësh boshnjakë, për rëndësinë e krijimit të identitetit boshnjak.

Dhe Noeli sapo e ka çmontuar këtë. Pra, ai nuk ka frikë të pranojë idetë e pranuara dhe vetëm të shohë nëse ato janë të vërteta, dhe t'i pranojë ose jo.

**33. Sir Noel Malcolm, All Souls College, Oxford**

Epo, shtysa më e madhe ishte vërtet situata politike në Kosovë dhe fakti që unë u përfshiva në debatin publik dhe komentimin e situatës në Jugosllavi, shumë kohë më parë. Thjesht duhet të shpjegoj se e fillova karrierën time si akademik në universitetin tim, në Cambridge. Më pas u bëra komentator i revistës "The Spectator" e më vonë, redaktor i huaj i asaj reviste. Kjo po ndodhte në fund të viteve 1980, atëherë kur po ndodhnin ngjarje të mëdha në ish-bllokun komunist. Dhe për shkak se e dija serbo-kroatishten, i ndiqja disi si më nga afër ngjarjet në Jugosllavi. Kur filloi lufta në Bosnjë, unë shkruaja shumë për të. E kuptova se politika perëndimore, për Bosnjën po bënte gabime. Kjo sepse, ata thjesht nuk e njihnin. Politikëbërësit, politikanët dhe diplomatët, thjesht nuk e dinin se me kë kishin të bënin, dhe dukej se i pranonin *a priori* pretendimet propagandistike që iu servireshin nga Beogradi.

Për shembull, Bosnja thuhej se ishte një vend i sajuar nga Tito, se ai kishte vizatuar një hartë duke tërhequr linja në mënyrë arbitrare, kur në fakt ajo ka kufij historikë, që nga shekulli i 17-të.

Pretendimi se vërtet serbët ishin aty historikisht, është përsëri qesharak.

Unë kam qenë i përfshirë si komentues dhe disi më privatisht, çfarë të them, një aktivist kundër kësaj lloj propagande të Beogradit. Unë e kuptova se nuk mund të fajësoheshin politikanët për këto gabime, sepse ata nuk mund të shkonin thjesht në një librari dhe të gjenin një libër mbi historinë e Bosnjës, që do të shpjegonte realitetin. Nuk kishte asgjë të tillë në dispozicion. Kështu, një ditë, mendova se do të shkruaja vetë një libër.
Dhe kështu, shumë shpejt shkrova Historinë e Bosnjës.
E them shpejt, pasi më mori një vit punë dhe u botua në vitin 1994.

**34.- Prof. David Abulafia**

Ai po interesohej gjithnjë e më shumë për historinë e ish-Jugosllavisë, gjë që e shtyu të shkruante një libër për Bosnjën. Dhe e mbaj mend që erdhi në kolegj për të mbajtur një leksion magjepsës, ndërkohë që libri për Bosnjën po përgatitej për *bogomilët*, për *heretikët*, për të cilët në disa tregime ka shumë polemika rreth tyre. Në mesjetë, ata u bënë forca dominuese brenda krishtërimit boshnjak, qartësisht para përhapjes së Islamit në Bosnjë.

**35. – Dr. Melanie McDonagh**

Po, është e vështirë të vlerësohet kontributi i Noelit. Në fillim të luftës në ish-Jugosllavi, njerëzit dinin aq pak për vendin dhe historinë. Micha Glenny pati shkruar një libër mbi shkatërrimin e Jugosllavisë, që në fillim të konfliktit në Slloveni dhe Kroaci.

Por nuk kishte specialistë të vërtetë që të shkruanin si duhet për rajonin dhe Noeli ishte ai që mund të sillte rrjedhshëm me aftësinë e një gazetari, me njohuritë e një studiuesi dhe aksesin e pashembullt të një gjuhëtari.

Ai ishte shumë i njohur me shumë prej politikanëve në Britaninë e asaj kohe, veçanërisht me Margaret Thatcher, e cila ishte shumë dashamirëse, siç e dini, për situatën e kosovarëve dhe boshnjakëve.

Ata njerëz kishin nevojë për dikë që të mund t'i besonin; ata kishin nevojë për një ekspert, ata kishin nevojë për dikë që e njihte rajonin. Noeli njeh edhe nivelin akademik, edhe nivelin njerëzor dhe personal, sepse ai kaloi kaq shumë kohë në zonë, duke shëtitur nëpër male, duke qëndruar me njerëz dhe familje të zakonshme në qendra banimi, qytete dhe fshatra në të gjithë ish-Jugosllavinë, dhe sigurisht në Shqipëri e në Kosovë. Dhe, ai i donte njerëzit. Ai, është e drejtë të thuhet, kishte një dashuri të madhe për njerëzit që takonte. Ky kombinim i dikujt që është një studiues shumë i shquar, një gjuhëtar i pashembullt dhe po ashtu një person me ndjesi të forta njerëzore ndaj situatatave dhe njerëzve të kohës, nuk kishte asnjë krahasim, sipas meje, me askënd tjetër.

Pra, kontributi i tij ishte pikërisht ai që duhej në atë kohë.

**36.- Sir Noel Malcolm**

Unë do të doja të mendoja se atëherë kishte një ndikim në politikëbërjen perëndimore. Por, kur e shkruaja atë, thellë në mendjen time e kisha gjithmonë Kosovën. Sepse, edhe pse mund të ketë dallime specifike ndërmjet dy rasteve, Kosovës dhe Bosnjës, ngjashmëria themelore ishte kjo:

Kishte pasur mosmarrëveshje politike, mosmarrëveshje politike moderne, ku shumë nga pretendimet kryesore politike ishin në thelb pretendime historike, dhe linja propagandistike shumë të ngjashme edhe për Kosovën gjithashtu, që rridhnin nga Akademia e Shkencave e Beogradit, nga historianët e njëanshëm në shërbim të interesave politike.

Kështu, sapo mbarova së shkruari *Historinë e Bosnjës*, mendova se detyra ime e radhës ishte të shkruaja *Historinë e Kosovës*.

**37.- Prof. Lea Ypi**

Unë e fillova me këtë admirim të pakushtëzuar për Noelin si akademik. Lexova librin e Kosovës, më bëri të kuptoj shumë gjëra rreth Kosovës, rreth fatit të Kosovës, origjinave, si duhej qasur çështja e Kosovës, si duhej qasur çështja shqiptare në përgjithësi, ndaj të gjithë atyre vendimmarrësve, politikanëve, aktivistëve të cilët nuk kanë ditur asgjë për Kosovën, kanë ditur edhe më pak sesa dija unë, nuk kanë ditur asgjë për vendin e Shqipërisë në botë, për çështjet midis Kosovës, problemet e kufijve etj., dhe kanë dashur thjesht të marrin informacion.

Dhe fakti që Noeli e ka dhënë atë informacion pa i rënë për shkurt, pa thjeshtëzuar, pa u përpjekur që të shfaqë, të japë një qasje ideologjike, domethënë thjesht duke paraqitur kërkimet e tij, burimet e tij, mënyra se si ai i ka interpretuar faktet, për mua ky është bërë një model shumë i rëndësishëm.

**38.- Sir Noel Malcolm**

Dhe, për këtë pata më shumë kohë. Për librin kushtuar Bosnjës më është dashur të punoj shpejt, gati një vit intensivisht, duke bërë kërkime e duke shkruar, ndërsa për Kosovën mendova se mund të bëj një punë edhe më të thelluar.

Kam kaluar tre vjet, kam shkuar në shumë arkiva, si në Vatikan, Venecia, Vjenë, Paris etj. Dhe mendoj se është një libër më i plotë dhe më shkencor.

Atë libër e kam botuar në vitin 1998, i cili ishte padyshim para luftës në Kosovë.

Përsëri, më pëlqen të mendoj se ky kishte një efekt te politikëbërësit perëndimorë kur më në fund shpërtheu lufta në Kosovë, dhe ndoshta dua të them, se ata e kuptuan gjithsesi se kishin bërë gabime të tmerrshme në Bosnjë, në fillim të viteve 1990. Disa nga ato gabime nuk u përsëritën në rastin e Kosovës.

Në mënyrë  intensive në mesin e viteve 1990, punoja për *Historinë e Kosovës*. Kjo ishte detyra kryesore që i dhashë vetes për tre vjet. Dhe sigurisht, për këtë më duhej të lexoja të gjithë literaturën e disponueshme në gjuhën shqipe për historinë e Kosovës dhe shumë gjëra të tjera.

**39.- Lutfi Dervishi**

Në atë kohë, si një bekim erdhi libri i tij i parë, që i kushtohet kauzës shqiptare - "Kosova, një Histori e Shkurtër".  Një libër që në fakt nxori në dritë jo thjesht të vërtetat shqiptare, por të vërtetën historike në raportet Shqipëri – Serbi. Është një libër që çmontoi për herë

të parë, në një shkallë të paprecedencë më parë, gënjeshtrën serbe për shqiptarët dhe për Kosovën.

Një libër që, nga raportimet e kohës thuhet se e mbanin në çantën e tyre diplomatët e kalibrit Hollbrook dhe vetë Sekretarja Madeleine Albright.

**40.- Dr. Daut Dauti**

Kur flas apo mendoj për Noel Malcolm-in, shpesh më vjen parasysh një fotografi e cila qe botuar në gazetat e mëdha këtu në Londër, në gazetat britanike në faqet e para, kur forcat britanike ishin ende në Maqedoni dhe prisnin të hynin në Kosovë. Ishte një fotografi shumë interesante dhe shumë simbolike - një ushtar britanik, i cili gjendej gjysmë i shtrirë dhe lexonte librin e Noel Malcolm-it.

Domethënë, përpara se të hynte njësia e tij në Kosovë, ai lexonte, do të thotë merrte informata në lidhje me popullin te i cili, tek vendi, ku do të shkonte.

Dikur nuk ka pasë informata aspak për Kosovën, nuk ka pasë informata objektive. E vërteta e shqiptarit apo e Kosovës, që është plasuar në Britaninë e Madhe, ka qenë kryesisht pan-sllave ose pan-greke, domethënë ka qenë çështja shqiptare tërësisht e injoruar apo edhe nëse ka qenë prezente në rrethet akademike të Britanisë së Madhe, ka qenë e parëndësishme, jo vetëm nga prezenca por edhe nga vlerësimi i akademikëve.

**41.- Sir Noel Malcolm**

Unë nuk ndihem përgjegjës për bombardimet e NATO-s. Një libër historie është libër historie. Nuk është një lloj dokumenti politikash për konfliktet. Ka pasur një lloj fushate në vitet 1990, nga simpatizantët e Beogradit dhe nacionalistët serbë në këtë vend, të cilët shkonin nëpër bibliotekat publike duke vendosur stampa mbi kopertinat e librit tim dhe libra të të tjerëve që unë i njoh, duke bërtitur: "Paralajmërim! Ky libër inkurajon fushatën e bombardimeve të NATO-s!".

Në fakt nuk e bëri këtë, sepse është një libër historie. Dhe historia ka të bëjë me të kaluarën.

Pra, unë nuk kërkoj kredite për këtë, por mendoj se do të doja të kërkoja një meritë të vogël për heqjen e disa supozimeve të rreme, që mund të kishin kufizuar politikën perëndimore, ose mund ta kishin dërguar atë në një drejtim tjetër.

Dhe siç e them, kjo është ajo çfarë u përpoqa të bëja në rastin e Bosnjës.

Dhe po, justifikimet për atë që po bënte Millosheviçi, i ishin dhënë atij nga Akademia e Shkencave, historianët, padyshim nga shumë gazetarë, shkrimtarë nga më të njohurit në Beograd.

Andaj jam përpjekur ta analizoj në atë libër me shumë kujdes, se çfarë është e vërtetë dhe çfarë është e rreme në pretendimet e ndryshme të paraqitura. Ka pasur pretendime të ekzagjeruara historikisht edhe nga shqiptarët, dhe kur mendoj se ka ekzagjerime, edhe këtë e them në libër. Kjo është detyra ime si historian.

**42.- Dr. Arjan Gjoncaj**

Sir Noeli ka një kontribut shumë përmasor do të thoja unë, për Shqipërinë, për çështjen tonë kombëtare.

Dhe kjo reflektohet tek kontributet që kanë veprat e tij, duke thënë se jo gjithçka që ne dimë për Betejën e Kosovës është e vërtetë në bazë të dokumenteve, dhe ai sjell dokumente të reja duke rritur rolin e shqiptarëve në Betejën e Kosovës.

**43.- Prof. Jason Tomes**

Mendoj se puna e tij ka pasur një rëndësi shumë të madhe, që bie më shumë në sy në rastin e librit "Kosova, një Histori e Shkurtër", e cila doli në vitin 1998 dhe që kishte një rëndësi që shkon përtej asaj që është thjesht historike, por mendoj se pati efekt të drejtpërdrejtë në perceptimin britanik për krizën e Kosovës.

Është një libër i cili bazohet aq qartë në kërkime skrupuloze arkivore, saqë pati peshë të vërtetë në prezantimin e britanikëve me dëshmi të mbizotërimit të gjatë historik të shqiptarëve brenda Kosovës.

Unë mendoj se për shumicën e britanikëve, nëse shumica e tyre kishin dëgjuar ndonjëherë për atë vend, për të qenë i sinqertë, nuk besoj se kishin dëgjuar asgjë përveçse në rastin e Betejës së Kosovës.

**44.- Sir Noel Malcolm**

Por është e vërtetë se shumica e pretendimeve të ekzagjeruara kanë ardhur nga historia serbe.

Është gjithashtu e vërtetë se shumica e shkrimeve historike vijnë nga Serbia, dhe kjo nuk është për t'u habitur.

Beogradi kishte një universitet që në shekullin e 19-të, kishte profesorë të historisë që shkruanin vepra të mëdha, disa prej të cilave u përkthyen në gjuhë të huaja që ndikojnë në interpretimin e historianëve perëndimorë dhe historianëve të Europës Perëndimore.

Gjatë gjithë shekullit të 20-të, nëse specialistët perëndimorë shkonin për të bërë kërkime doktorature mbi historinë e Jugosllavisë, zakonisht shkonin në Beograd. Shumë pak shkonin në Zagreb. Askush nuk shkonte në Prishtinë.

**45.- Lord Charles Moore**

Në të vërtetë, më kujtohet se Noeli ishte personi i parë që më shpjegoi në mënyrë specifike se çfarë po ndodhte me Millosheviçin në fund të viteve 1980, kur Millosheviçi mbajti atë fjalimin e famshëm.

Pra, ishte Noeli që më shpjegoi për herë të parë rëndësinë e fjalimit të Millosheviçit për Betejën e Kosovës, dhe shkroi për përvjetorin e saj në vitin 1989.

Unë nuk dija fare për këtë dhe nuk besoj se shumica e lexuesve tanë dinin gjë për këtë. Ishte ai që ua hapi këtë temë lexuesve të "The Spectator", dhe më pas lexuesve të "The Telegraph".

Një nga gjërat më të mira të Noelit në gjenialitetin e tij të madh, është se ai thjesht di më shumë për një temë që i intereson, sesa njerëzit e tjerë. Pra, ishte gjithmonë shumë zbavitëse ta shihje atë në shoqërinë e njerëzve të tjerë që pretendojnë se janë ekspertë.

Kishte njerëz, që jetojnë në këtë vend, të cilët pretendojnë se janë ekspertë të rajonit dhe vendeve të tjera, për të cilat ai dinte shumë, shumë më tepër se ata. Unë e kam vënë re këtë disa herë.

Pra, ai ishte jashtëzakonisht i fuqishëm në paraqitjen e argumenteve dhe ashtu vazhdoi.

Thashë, në një farë mënyre ishte Rumania dhe pastaj me sekuenca erdhi Millosheviçi, dhe e gjithë kjo mbi çështjen e Bosnjës, dhe që aty doli çështja e Kosovës dhe çështja shqiptare.

Dhe ju mund ta shihni atë sekuencë duke ardhur në "The Spectator" dhe më pas në "The Telegraph", dhe natyrisht në të gjitha llojet e forumeve të tjera.

**46. - Bejtullah Destani**

Kontributi i tij i jshtëzakonshëm për ndihmën e Luftës së Kosovës dhe sidomos periudhën para luftës është jashtëzakonisht i madh, për çka opinioni i gjerë nuk e njeh. Në "Telegraph" ishte *Foreign Editor*, dhe kishte një polemikë të jashtëzakonshme me

Ministrin e Jashtëm të kohës, Dauglas Hurd, i cili ishte në politikën e tij shumë proserb dhe e përkrahte idenë e Beogradit. Noel Malcolm pati pasë një polemikë të forte, dhe e detyroi atë që në fund të bindej me fakte - që i kishte shtruar për punën e situatës në terren të Kosovës, në krahasim me ato që kishte sugjeruar Dauglas Hurd.

**47. - Sir Noel Malcolm**

Pra, ata përvetësuan një lloj pikëpamjeje serbe dhe në shumë raste, pikëpamje që bazoheshin përfundimisht në idetë nacionaliste që shkojnë prapa në shekullin e 19-të, në përgjithësi, jo shumë më herët se kaq.

Pasi të shkosh në arkiva, të shpalosësh dokumentet, do të zbulosh se shumë prej tyre bazohen thjesht në keqinterpretime. Pra, po përpiqesha shumë të merresha me të. Dhe vetëm për të dhënë një lloj rrëfimi faktikisht të saktë të historisë; ishte vetë natyra e saj që i zhbënte shumë nga këto pretendime që vinin nga historia serbe.

**48.- Prof. Rexhep Ismajli**

Libri i Malcolm-it erdhi në një moment kur e daraviti tërë këtë mjegull dhe tregoi qartë, nga një burim tjetër, jo i yni, sepse neve nuk na besonin, neutral, me një gjuhë shumë të qartë, me një shkrim brilliant, nga Britania erdhi një libër i cili tregonte se ku ishte Kosova, çfarë ishte, sa mund të shihet ajo si entitet i tashëm apo ishte vetëm entitet që u krijua në Federatën Jugosllave, apo kishte edhe diçka tjetër, si rajon i mëhershëm.

Dhe ai tregonte qartë se Kosova ka logjikën e vet si entitet, pavarësisht se ka qenë e sunduar nga ky ose ai në historinë e saj. Me këtë, ai i dëshmoi botës, dhe sidomos botës që merrte vendime në diplomacinë e lartë perëndimore, sepse libri i tij lexohej atje. Ky libër tregon se Kosova ka arsyen e vet të ekzistencës, të ketë historinë e njësisë federale që ka pasur, të jetë pjesë e luftës që po zhvillon, dhe të shpallë lëvizjen paqësore të Republikës, etj.

**49.- John Hudgson**

Noel Malcolm e nxori Historinë e tij të Kosovës fill para Luftës së Kosovës. Kjo është një vepër shumë e madhe historike, sepse Malcolm-i është një ndër historianët tanë më të shquar. Ai krijoi një 'pikturë' të Kosovës dhe krijoi identitetin e Kosovës në mendjen e lexuesit britanik. Do të thotë, më parë Kosova ishte vend i panjohur për ne. Noel Malcolm e bëri atë vend të gjallë dhe të pranishëm në kulturën tonë. Do të thotë, është një vepër

për të gjitha kohërat, një vepër me shumë peshë, që doli në një moment të caktuar, saktësisht në momentin e duhur.

**50.- Dr. Rudina Jasini**

Për çdo të huaj që dëshiron të dijë lidhur me natyrën e konfliktit që lindi në Kosovë, mendoj dhe e rekomandoj gjithmonë librin e Noel Malcolm-it, si një fillesë shumë e mirë për të arritur dhe për të kuptuar se, përse Kosova është aty ku është sot.

Në botën akademike, diskutimet që bëhen janë shpeshherë të ashpra. Pra, ti mund të kesh personalitete dhe dijetarë të kalibrit shumë të lartë në të dy anët e spektrit, të cilët debatojnë vërtet duke sjellë argumente, mendime, fakte të hulumtuara prej vitesh.

Pra, sapo të hysh në atë lloj debati intelektual, aty pastaj kupton edhe vlerën e punës së Sir Noel Malcolm.

**51. – Prof. David Abulafia**

Kosova, po shfaqej ashtu siç ai e botoi në *Historinë e Kosovës*, po shfaqej si një fushë tjetër ku kjo bashkëjetesë ishte prishur në mënyrë dramatike, pra bashkëjetesa mes shqiptarëve dhe serbëve.

Pra, kishte një lloj përparimi logjik, saqë në një moment ai do të ishte shumë i interesuar edhe për Shqipërinë, deri në atë masë sa një ditë më tha se kishte filluar të mësonte shqip dhe e mësoi atë si autodidakt me librat e gramatikës shqipe, e kështu me radhë.

**52.- Dr. Daut Dauti**

Ndikimi ka qenë i madh. Për atë arsye, duket se botimi i kësaj vepre e ka ndryshuar edhe mendimin e politikës së jashtme britanike ndaj çështjes shqiptare. Por edhe e ka pasuruar historiografinë shqiptare.

**53.- Robert Wilton**

Kosova është bërë vendi im. Unë e kam këtë nder.

Kur njerëzit më pyesin për rekomandimet e mia, qysh me e kuptue Kosovën, a ka diçka me lexue, unë iu sugjeroj, veç nëse ti don me kuptue sfondin, *backgroundin* për kontraversët, sa i takon Kosovës, lexo vetëm 90 faqet e para të Sir Noelit. Gjithçka është

aty, në një mënyrë supershkencore, e ftohtë, pa ekzagjerim, pa melodramë. Gjithçka është aty, edhe kurrë nuk ka qenë e tejkaluar arritja e tij në paraqitjen e çështjes së Kosovës.

Dhe kjo ndoshta është arritja e tij ma e madhe, që ai ka sjellë në shkrimin e historisë së Ballkanit, standardin shkencor, ndërkombëtar, të rangut të parë. Është një shërbim esencial për standardet akademike, edhe në Ballkan.

**54.- Dr. David Shankland**

Në pozicionin tim të parë akademik, kur isha vendosur në Institutin Britanik të Arkeologjisë në Ankara, erdhi dhe më vizitoi Sir Noel Malcolm. Ai ishte në një nga turnetë e tij në Ballkan dhe vendosi të më vizitonte.
Isha absolutisht i lumtur kur e pashë, ndërsa kishte sjellë me vete një dhuratë të vogël. Ai solli me vete një kopje të *Historisë së shkurtër*; "Kosova, një Histori e Shkurtër", është një shembull i shkëlqyer se si mund të bëhet një libër i cili meriton të jetë i famshëm.

**55.- Sir Noel Malcolm**

Po, nëse flasim për Akademinë e Shkencave të Serbisë, unë pata nderin surprizues të një konference që ata mbajtën në Beograd për librin tim. Më pas, botuan një vëllim me prezantimet e konferencës. Unë kam një kopje të atij botimi voluminoz.

E lexova kur doli nga botimi. Mendova se ishte një lloj komplimenti për mua, kur pashë se ata mblodhën një ekip historianësh të tyre për të më sulmuar mua. Prandaj e lexova me vëmendje. Por nuk gjeta dot asnjë argument të vetëm, të qartë dhe faktik, kundër asaj që kisha thënë në libër. Ishte një person që pretendonte se të gjitha statistikat e mia ishin të gabuara për Kosovën osmane në periudhën e vonë. Por ai person bënte një gabim elementar, sepse kishte marrë vetëm statistika nga Vilajeti i Kosovës, i cili nuk ishte Kosova moderne. Ai përfshinte gjysmën e Maqedonisë dhe unë gjithmonë i kisha ndarë në njësi territorial, që nga Vilajeti deri në nivelin e Kazasë, për të përfaqësuar atë që në të vërtetë do t'i përgjigjej Kosovës moderne. Ky ishte një gabim i trashë.

Por megjithatë, siç e ndjej unë, ky ishte një lloj komplimenti i çuditshëm - të sulmohesha nga një konferencë dhe një libër i tërë, i tillë.

**56- Dr. Edita Tahiri**

Ndërsa unë mund të them që për neve si themelues të shtetit të Kosovës, Malcolm është bashkë-themelues i shtetit të Kosovës, sepse libri i tij paraqiti të vërtetën e historisë së Kosovës dhe rrëzoi tezat e rrejshme nacionaliste të Serbisë dhe neve na solli në skenën botërore pra, si një çështje që pak njihej nga shumë anë.

**57.- Michael Gunn**

Për sa i përket punës akademike, më duhet të them se Sir Noel Malcolm është aq i njohur, dhe qëndron në krye të të gjithë historianëve, sidomos po t'i referohemi librit "Kosova një Histori e Shkurtër", që doli në vitin 1998. Libri ngjan me një punë seminari dhe duhet të konsiderohet si një vepër ndriçuese e mendjeve të çdo studenti të historisë së shqiptarëve, përfshirë edhe ata të Kosovës.

**58.- Edith Harxhi**

Duke qenë e Ngarkuar e Posaçme e qeverisë shqiptare për njohjen e Kosovës në botë, dhe me një angazhim të drejpërdrejtë për të ndihmuar në njohjen e Kosovës nga vende të cilat nuk e kishin njohur mbas shpalljes së pavarësisë së saj, u takova me shumë diplomatë të huaj, personalitete, ministra të jashtëm, kryeministra, ish - kryeministra dhe presidentë në botë, të cilëve në lobimin tim dhe në lobimin e shtetit shqiptar për njohjen e pavarësisë së Kosovës, iu dhurova librin "Kosova, A Short History" të Noel Malcolm.

Unë natyrisht e falënderoj profesor Malcolm-in, sepse ky ka qenë një shërbim i jashtëzakonshëm për shërbimin diplomatik shqiptar në veçanti, por edhe për njohjen e Kosovës nga kancelari të huaja dhe njohjes së historisë së saj nga kancelaritë e huaja, në veçanti, të dramës shqiptare në shekuj.

Natyrisht pyetja sot do të ishte: a jemi ne shqiptarë, vëllezër, në të dy anët e kufirit? Dhe këtë pyetje ia bëj profesor Malcolm-it!

**59.- Sir Noel Malcolm**

"Dhe në pjesën më të madhe të historisë, nuk mund të bëhet një ndarje e saktë midis Kosovës, Shqipërisë së Veriut apo zonave të tjera ku kanë jetuar shqiptarët. Kështu që, kjo më tërhoqi edhe më shumë drejt historisë së përgjithshme të shqiptarëve.

## EPISODI I TRETE

## SHQIPTARËT:

## AGJENTË PERANDORAKË

## REBELËT, BESIMTARËT, TË MBIJETUARIT

## AGJENTË PERANDORAKË







*Ky është një libër i rrallë, i papërshkrueshëm për euridicionin, diapazonin dhe lexueshmërinë e tij…Me gjithë morinë e detajeve, Noel Malcolm-i nuk e harron asnjëherë panoramën e gjërë dhe shpalos pareshtur analiza të reja, jo vetëm të episodeve të njohura të tilla si Beteja e Lepantos por edhe të historisë së përgjithshme të marrëdhënjeve ndërmjet Perëndimit dhe Perandorisë Osmane. Për mendimin tim, ky libër është një kryevepër.*

*Sir John Elliot, Prrofesor Regius Emeritus i Historisë në Universitetin Oksford.*

**60.- Mal Berisha**

Në muajin maj të vitit 2015, Sir Noel Malcolm, në cilësinë e Presidentit të Shoqatës Anglo-Shqiptare, e themeluar që në vitin 1912 nga koloneli anglez Aubrey Herbert dhe antropologia Edith Durham, erdhi si zakonisht në ambasadën shqiptare në Londër.

Kësaj here ai paraqiti një kërkesë të veçantë në mënyrën e tij aq modeste, siç është ai vetë, por shumë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar.

Ai dëshironte të prezantonte për herë të parë librin e tij të radhës, "Agjentët Perandorakë".
Natyrisht, ai mund ta bëntë këtë në çdo institucion të rëndësishëm të vendit të tij. Por zgjodhi ambasadën shqiptare, për t'i dhënë kuptim edhe më simbolik veprës që kishte shkruar për ne shqiptarët.
Padyshim, ky ishte një nder shumë i madh për ambasadën shqiptare në Londër, sa edhe për krejt kombin tonë.
Kështu, më datë 2 qershor të vitit 2015, në mjediset e ambasadës u bë promovimi i këtij libri. Nëse do të veçohej një konkluzion nga ky libër, ai do të ishte:
"Nëse dikush dëshironte të bënte ndonjë lloj biznesi me Perandorinë Otomane, duhej patjetër të kishte njohje të paktën me një shqiptar."

**61.- Sir Noel Malcolm**

Ashtu si shumë gjëra që i ndodhin njeriut, kjo ndodhi edhe me mua; ndoshta sepse fati më ndihmoi ose sepse, në një masë të madhe më ndihmoi rastësia. Kjo ndodhi krejt papritur, por ja që ndodhi. Dhe, ja si ndodhi...

Rreth 20 vjet më parë po lexoja një traktat shumë interesant italian mbi Perandorinë Osmane, shkruar nga Lazaro Soranzos, me titull "L'Ottomanno", botuar në vitin 1598. Ai në një vend shkruante se ekzistonte një traktat shumë i rëndësishëm mbi Perandorinë Osmane, në pjesën europiane të kapitullit, të cilin duhet ta lexoni.

Dy faqe më tej, ai thoshte për shqiptarët:

"Nëse dëshironi të dini më shumë për ta, duhet të lexoni atë traktat, i cili gjendet në një dorëshkrim të bashkëatdhetarit të tyre, Lord *compatriota*, Antonio Bruni."

Për pak sa nuk rashë nga karrigia në atë moment, sepse mendova: Ja një tekst, një traktat i shekullit të 16-të për shqiptarët.

Ja Shqipëria! Ky është një dokument krejtësisht i panjohur. Askush nuk i është referuar ndonjëherë këtij dokumenti dhe thjesht, nëse do ta gjeja, do të ishte teksti i vetëm, i panjohur, për Shqipërinë, i shkruar nga një shqiptar.

Ishte një tekst shumë interesant, jo shumë i gjatë. Ishte një traktat italian. Mendova ta botoj me një hyrje të vogël për autorin.

Këtu filluan problemet, pasi unë nuk dija asgjë për këtë njeri, përveç emrit të tij, që është një emër shumë i zakonshëm, italian në dukje, Antonio Bruni. Në faqen e parë, ku gjendej titulli, shkruhej se ai ishte nga Dolçinio (Ulqini në Mal të Zi, Ulqin për shqiptarët), që ka qenë gjithmonë një qytet shqipfolës, i cili gjendet në skajin jugor të Malit të Zi, shumë afër kufirit shqiptar.

Kështu, nëse flasim në mënyrë metaforike, fillova të gërmoj dhe gjeta disa detaje të tjera për familjen e tij. Gradualisht, faqe pas faqeje po nxirrja nga errësira totale diçka që unë nuk mund t'u besoja syve, për atë që po shihja.

Për shembull, babai i tij doli se ishte Kalorësi i Parë i Maltës, i cili ishte një talent i pikasur nga Papa. Ai ishte dërguar të organizonte shërbimet e fshehta në Dubrovnik dhe më pas u bë kapiten i anijes papnore në Betejën e Lepantos. Ai shërbeu si kapiten i anijes në Flotën Papale, në tri fushata.

Ai u dërgua po ashtu si komandant këmbësorie në territorin papnor në Avignon.

Pra, ky ishte babai, por nuk ishte i vetmi. Një xhaxha i tij u bë kryepeshkop, Primat i gjithë Serbisë, ku kishte me dhjetëra peshkopë nën kryepeshkopatën e tij.

Ai mori pjesë në Këshillin e Trentit, ku luajti një rol absolutisht vendimtar në çështjet e rëndësishme të seancës së fundit të këtij Këshilli. Ai u kthye në vendin e tij, në atë që tani është Mali i Zi, por që mbulon pjesë të mëdha të Shqipërisë moderne, dhe gjeti një fund shumë të hidhur dhe tragjik, në fund të Betejës së Lepantos. Ai në fakt nuk u vra nga osmanët, por unë nuk dua ta devijoj historinë.

Një dajë tjetër, dhe këtu dy familjet ndërthurin Brunin dhe Brutin, që tregon se emrat janë pothuajse identikë, por që është krejtësisht një rastësi.

Ai ishte shefi diplomatik dhe tregtar i Venecias, në të gjithë këtë rajon të Ballkanit Perëndimor. Ai ishte njeriu që zgjidhte probleme të ndërlikuara, që fliste me pashallarët osmanë në anën tjetër të kufirit, sepse këta njerëz gjendeshin pikërisht në vijën e kufirit ndarës. Këta njerëz ishin shqiptarë, por nënshtetas të Venecias.

Pra, ata vepronin të gjithë si katolikë romakë. Ata punonin për Perëndimin, pikërisht në këtë brez kufitar. Pra, ai ishte shumë i rëndësishëm edhe si tregtar drithi që mbante gjallë Venedikun, sepse prodhonte dhe organizonte furnizmin me 9.000 tonë drithë në vit, që ishte sa i gjithë konsumi vjetor i tij, pa të cilin venecianët nuk do të mund të ekzistonin.

Djali i tij fillon një karrierë edhe më të jashtëzakonshme. Ai shkon në Stamboll që në fëmijëri, për t'u trajnuar si *dragoman* dhe përkthyes profesionist.

Shumë shpejt, ai e kupton se kjo nuk ishte puna që dëshironte të bënte në jetën e tij. Prandaj, ai regjistrohet në rrjetin sekret spanjoll të spiunazhit në Stamboll. Pastaj shkon në Madrid dhe ngarkohet me një detyrë të rëndësishme për të shoqëruar një mision diplomatik sekret, një lloj misioni diplomatik të fshehtë, për të negociuar një armëpushim midis Filipit II të Spanjës dhe Vezirit të Madh.

Ai e bën këtë për një kohë të shkurtër, por përballet me konflikte me diplomatët spanjollë dhe më pas shkon në Moldavi dhe bëhet Kryeministër, komandant i ushtrisë së saj dhe drejton pothuajse të gjithë vendin.

Por ky ishte një vend brenda Perandorisë Osmane, kështu që, në fund të fundit, ai punonte në njëfarë kuptimi për osmanët për 12 vitet e ardhshëm. Dhe pastaj ai ndeshet me një fund tepër të keq, që unë do ta shpjegoj më poshtë.

Këta janë vetëm disa prej tyre, por ka shumë më tepër *dragomanë*. Madje është njëri prej tyre që pothuajse e ndalon të gjithë luftën midis Habsburgëve dhe Osmanëve, e cila shpërtheu në vitin 1593. Kjo luftë u ndalua thuajse, falë një anëtari të kësaj familjeje.

Pas tre vjetësh, një tjetër anëtar i kësaj familjeje dërgohet në një mision paqeje te perandori Rudolf në Pragë, me qëllim që ta ndalojë sërish, por me më pak sukses.

**62.- Prof. David Abulafia**

Ajo që Noeli bën në librin e tij, çka është jashtëzakonisht e rëndësishme, është se ai e kthen individin përsëri në histori; mendoj se është absolutisht jetësore. Kështu që, ai i shikon këto familje shqiptare, Bruni dhe Bruti, në atë mënyrë që t'i jepet fokusi shqiptar dhe mënyra sesi njerëzit me një lloj rëndësie dytësore, silleshin në historinë e Mesdheut.

Megjithatë, roli i tyre si vëzhgues del në të gjitha llojet e ngjarjeve kyçe, duke përfshirë Betejën e Lepantos, lidhjet e tyre me princat e Moldavisë, lidhjet e tyre me të vërtetë edhe me oborrin në Kostandinopojë, Oborrin Osman në Kostandinopojë.

Njëri nga të afërmit e tyre arriti të bëhej Vezir i Madh, ndërkohë që ishte bërë musliman dhe kështu me radhë, ai u ngrit në hierarkinë më të lartë të Perandorisë Osmane.

Pra, është ai lloj kuptimi i vendosjes së këtyre individëve brenda një konteksti më të gjerë, dhe i shfaqjes dhe vendosjes së Shqipërisë në atë kontekst më të gjerë. Pra, nuk është një histori lokale e Shqipërisë në shekullin e 17-të, por kjo është pikë vërtet e rëndësishme për të, siç më duket mua.

Dua të them se ai shkruan për historinë e shqiptarëve, jo për historinë e një cope territori dhe kështu na bën të kuptojmë vetë historinë e shqiptarëve.

Nuk më takon mua ta them këtë, pasi shqiptarët e kuptojnë këtë më mirë sesa unë, këtë kuptim mbi të gjitha llojet e aspekteve të historisë.

Këtu le të përmendim Italinë, shqiptarët në Itali, shqiptarët në shekujt e mëvonshëm në Aleksandri, në Egjipt, shqiptarët që u përhapën në të gjithë Perandorinë Osmane, duke luajtur këtë rol të jashtëzakonshëm, ndonjëherë në vetë qeverinë e Perandorisë Osmane.

**63.- Prof. Jason Tomes**

Shqipëria në shekujt e kaluar, pra shqiptarët, kanë qenë të përfshirë ngushtë në ndërveprimet vendimtare midis Botës Islame dhe Europës së krishterë. Libri i Noel Malcolm "Agjentë Perandorakë", që i vendos ngjarjet në shekullin e 16-të, i tregon shqiptarët të përfshirë thellësisht nga të dyja anët, në atë që shihej atëherë si një luftë e madhe për kontrollin e Mesdheut.

Mendoj se ai libër solli në plan të parë faktin se shqiptarët ishin detarë, njerëz urbanë, që bënin tregti me vendet e tjera, kur ndoshta në mesin e njerëzve brenda vendit tonë, që mendojnë se kanë një farë njohurie për Shqipërinë, gjenden prej atyre që janë ndikuar së tepërmi nga etnografia, librat e prodhuar në fund të viteve 1930 të shekullit të 20-të, duke i menduar të gjithë shqiptarët si fisnorë të maleve dhe duke mos marrë parasysh faktin se ata kanë qenë njerëz tregtarë dhe të arsimuar, që do të udhëtonin dhe do të kishin kontakte me të huajt, me një botë shumë më të gjerë ekonomike dhe sociale.

**64.- Sir Noel Malcolm**

Pra, libri në një nivel është një paraqitje biografike e këtyre njerëzve, sepse historia e familjes së tyre është e jashtëzakonshme. Të gjithë këta janë individë që kanë bërë gjëra interesante.

Unë kam punuar për shumë vite në një mënyrë shumë më të gjerë për marrëdhëniet Lindje-Perëndim në atë periudhë, marrëdhëniet mes pjesës së krishterë të Europës dhe asaj Osmane. Në terma praktike, kjo mbulon spektrin e llojit të piraterisë luftarake, gjëra të tilla, përmes spiunazhit në diplomaci dhe tregti.

Në anën tjetër të spektrit, në fakt, perëndimorët punojnë për osmanët.

Thjesht rastësisht, anëtarët e kësaj familjeje mbushnin çdo vend të zbrazur të gjithë asaj hapësire.

Kështu që, mendova të shkruaja një libër që është një lloj biografie selektive, t'i tregoja këto histori, sepse ishin aq të bukura sa ishte mëkat t'i humbisnim, dhe në të njëjtën kohë ta përdor atë si kornizë për diçka shumë më të madhe, që është një përshkrim më i gjerë tematik i të gjithave, që nga mënyrat interesante në të cilat Lindja dhe Perëndimi ndërvepronin në atë kohë dhe në të njëjtën kohë përpiqeshin të ndërtonin një lloj përshkrimi gjeopolitik të asaj që po ndodhte rreth Betejës së Lepantos dhe shpërthimit të Luftës së Habsburgëve.

Pra, është një libër mjaft i vështirë për t'u përshkruar, pasi ka më shumë se një element që duhet të shpjegohet, por shpresoj që të paktën disa pjesë të tij janë bërë të qarta. Këto janë pikat kryesore të tij, dhe ndodh që teksa shkruaj për të dhe bëj kërkime, has gjithnjë e në më shumë shqiptarë, pasi ata janë kudo.

Shqiptarët gjenden si ushtarë, oficerë në Itali, si dhe shqiptarë të tjerë që shërbejnë në administratën osmane në Stamboll. Një arsye pse këtyre njerëzve iu shkojnë mirë punët në Stamboll, është se ata kanë një kushëri të largët që është bërë Vezir i Madh.

Sinan Pashë Topojani - Ai, në fakt, drejtonte Perandorinë Osmane dhe ishte shqiptar nga një fshat i vogël i quajtur Topojan, të cilin e vizitova dhe shëtita rreth shatërvanit të Sinan Pashës, pra, në Topojan.

Pra, për t'ju dhënë një ide, libri përfundon në fund të shekullit të 16-të. Kjo luftë e tmerrshme Habsburgo-Otomane ka filluar rreth vitit 1600.

Komplotet e saj shkatërruese janë ndjerë në Europën Qendrore, Transilvani, Vllahi, pra në atë që tani është pjesa jugore e Rumanisë. Por në momentin kur unë mbarova librin, kryekomandanti në terren, në anën Osmane, quhej Jemishçi Hasan Pasha; ai ishte shqiptar, ndoshta nipi i Sinan Pashë Topojanit. Pra, komandanti në anën shqiptare është shqiptar…

**65.- Prof. Rexhep Ismajli**

Këtu Malcolm-i shkëlqen vërtet si hartues, si shkrimtar i historiografisë. Shkëlqen edhe me faktin se sjell mënyra të reja të shkrimit të historisë, me një gjuhë shumë të bukur, me një rrëfim të qartë.

Ai ka marrë familje shqiptare nga Ulqini, që kanë jetuar në vise të ndryshme të botës Perëndimore e pastaj edhe Lindore, edhe në Stamboll edhe në Moldavi, edhe në vise të tjera.

Dhe ato familje pastaj, siç e thotë ai, me aftësitë e tyre, këta njerëz me aftësinë e tyre për ta tejkaluar, për të dalë përtej anëshmërisë së vet kulturore, për t'u marrë edhe me tjetrin, edhe identifikimin me tjetrin, e të tjera.

Domethënë ishin katolikë, por dilnin edhe nga ana e myslimanëve. Në Stamboll, për shembull, e bënin të mundshme që të komunikonin midis këtyre botërave të armiqësuara. Dhe aty kishte përkthyes, kishte *dragoman*. *Dragoman*-ët kanë qenë jo veç përkthyes. Nëpër ambasada i kanë mbajtur edhe si njerëz që marrin edhe shënime, që mbledhin informacione, bëjnë ndërmjetësime.

Edhe flet, e bën një histori të tërë pjesës europiane, jo vetëm shqiptare. Pra të Venedikut si supërfuqi, pjesërisht Spanjës, Polonisë, të Ballkanit, të Italisë tjetër, me Papët, dhe të Perandorisë Osmane. Dhe në atë vorbull, ai flet edhe për botën shqiptare, për vendet shqiptare: si janë, si bëhet jeta atje? Ai flet atje për shembull, përveç diplomatëve, tregtarëve etj., ai flet edhe për diplomatë që shesin grurë nga Durrësi. Dhe na tregon historinë.

Domethënë është një histori, pak a shumë si, mua më kujton "Mesdheu" i Fernand Broudel, është një historian i pjesës së parë të shekullit të njëzetë, francez, që ka bërë një përmbysje kundër valëve të historiografisë së sistemuar.

Malcolm-i shkon nga mikro-historia e këtyre familjeve, del te makro-historia dhe na jep pasqyrën e botnave që janë në konflikt, në luftë: bota e Perëndimit, Venediku dhe shtetet e tjera të fuqishme, Spanja, e kështu me Perandorinë Osmane.

**66.- Robert Wilton, shkrimtar & diplomat britaniko – kosovar**

Është një Paradë e Epokës, është si ato kryeveprat historiografike të Europës , "Lufta e Vespersëve Sicilianë" të Runciman-it.

Më duhet të them se, kur dikush siç është Sir Noel, nga rangu i parë botëror në shkrimin e historisë, na sjell diçka për rajonin, me një standard ndërkombëtar të shkrimit të historisë, është edhe më e çmueshme. "Agjentët Perandorakë" është fantastik në këtë drejtim, në paraqitjen e historisë jo vetëm të një familjeje, teksa ne menjëherë kuptojmë se po lexojmë jo vetëm për një familje, jo vetëm për Brunin dhe Brutin, por për krejt shoqërinë e rajonit dhe jo vetëm për rajonin e Ballkanit, por për botën e njohur të asaj kohe, botën europiane të asaj kohe.

**67.- Dr. Melanie McDonagh**

Pothuajse të gjithë ata që shkruajnë për Ballkanin, janë specialistë për Ballkanin.

Noeli është një specialist i mendimit intelektual të shekullit të 17-të, dhe kjo nuk është thjesht një prirje anësore. Kjo është fusha kryesore e interesit të tij akademik.

Pra, shumë akademikë, shumë studiues, përfshirë ata në Serbi, ishin absolutisht të habitur nga mendimi se si dikush që nuk ishte specialist i Ballkanit, arriti të hynte aty ku ata dështuan, duke dhënë një përshkrim të gjerë, bindës dhe gjithëpërfshirës të rajonit, të cilin asnjëri prej tyre nuk e kishte bërë dot.

**68 - Bejtullah Destani**

Në fakt këtë libër Noeli e përgatiti përgjatë procesit të punës duke shkruar një libër tjetër. Ai nuk e kishte si qëllim që ta shkruante këtë libër. Sipas dëshmisë së Noelit, ai filloi të shkruante një libër me titull "Useful Enemies", një libër për historinë e Islamit nga viti 1473 deri në vitin 1720, viti kur është botuar libri i Volterit në gjuhën frënge. Gjatë përpunimit të këtij libri, ndërkohë i dolën këta *agjentët perandorakë*, familja Bruni dhe Bruti, për mendimin nga dy familje, nga dy persona fillimisht e më pas numri i aktorëve u rrit. Kishte aq mundësi që të bëhëj një libër, i cili është përkthyer në shumë gjuhë botnore, spanjisht, italisht, turqisht, arabisht, edhe kinezërisht është botuar.
Madje, nuk e kuptonte në fillim, pse kinezërisht?

I fola mbi çështjen e lidhjeve të Shqipërisë me Kinën. Kjo të ka ndihmuar, përndryshe nuk do të ishte botuar. Më duket se ka mbi 20.000 kinezë që flasin shqip. Kjo ka qenë si një lloj ndikimi më duket.

Një recension që kam lexuar në një revistë akademike të Harvardit, ishte i përkryer. Sipas recensionit për librin "Agjentë Perandorakë", Shqipërinë e ka kthyer në hartën e Europës, ku s'ka ekzistuar fare. Po të kishte mundësi establishmenti politik shqiptar ta përdorte këtë libër për promovimin e vendit, do të ishte një gjë fantastike. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi.

**69.- Alda Bardhyli**

Këtu në hapësirat e Qendrës Kombëtare të Librit dhe të Leximit i kemi pothuajse të gjithë librat e Noel Malcolm-it. Kemi pasur rastin ta takojmë dhe të jemi pjesë edhe e nderimit që iu bë atij nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Librat e Noel Malcolm-it janë një ftesë shumë e bukur për gjithë të huajt, por jo vetëm për të huajt, për të gjithë ata që duan ta njohin historinë e Shqipërisë dhe të Kosovës, por jo vetëm kaq. Do të thosha, për të gjithë ata që duan të njohin historinë rajonit tonë, Ballkanit tonë, dhe rolin thelbësor që shqiptarët kanë pasur në procese apo në faza të ndryshme historike të zhvillimit të këtij rajoni.

Noel Malcolm është më i rëndësishmi, ndoshta edhe për faktin se veprat e tij kanë hyrë në zona ku edhe Historia e Shqipërisë ende nuk ka hyrë, duke përshfaqur në një farë mënyre një lloj përqasjeje europiane të shqiptarëve, të cilët kanë qenë herët pjesë e Europës.

## REBELËT, BESIMTARËT, TË MBIJETUARIT







**70.- Mal Berisha**

Në vitin 2020, Sir Noel Malcolm vjen me një libër tjetër. Edhe ky libër në fakt merret me një pamje të plotë dhe realiste të historisë së vendit tonë.

Për Sir Noel Malcolm, historia e tokave shqiptare është pak e njohur dhe pak e studiuar. Kjo vjen si pasojë e një shpërfilljeje dhe ndjesie izolimi gjatë kohës së komunizmit.

Tokat shqiptare, sipas tij, kanë një histori të gjatë të ndërveprimit me të tjerët.
Të 12 studimet që përbëjnë librin, përfshijnë një varg temash shumë interesante shqiptare, që prej shekullit të pesëmbëdhjetë e deri te shkërmoqja e mitit serb për të ashtuquajturën "Dyndje e Madhe", dhe ndërthuren me politika ndërkombëtare, në pikëtakimin mes Krishtërimit dhe Islamit, si dhe çështjen e identiteteve.

Sir Noel Malcom tregon se si tokat shqiptare kanë qenë një pikëthyerjeje mes krishtërimit dhe islamit, një kanal përmes të cilit Venediku lidhej me Ballkanin Osman, një vend interesi për Habsburgët dhe një vatër për lakmitë e fuqive dhe fqinjëve të popullit tonë.

Kjo vepër ka sjellë risi të jashtëzakonëshme për historiografinë shqiptare, të cilat do të shtjellohen në këtë episod të tretë të dokumentarit "Mirënjohje", kushtuar këtij historiani kaq të shquar të kohës tonë.

**71.- Sir Noel Malcolm**

Po, është një përmbledhje e eseve të mia për tema të ndryshme shqiptare, dhe tema historike. Pra, eseja e parë u botua 25 vjet më parë, kështu që në këtë kuptim, mund të thoni se kam punuar me siguri për 25 vjet.

Por, vetëm pasi kisha botuar në vende të ndryshme, revista të mbledhura, vëllime të studimeve të vjetra, për tema të ndryshme, vetëm pasi botova tani 7, 8, 9, (prej tyre), një mik shumë i mirë, Bejtulla Destani, i cili është vetë një studiues i mrekullueshëm i historisë shqiptare të të gjitha llojeve dhe një ekspert i jashtëzakonshëm i arkivave dhe dokumentacionit, më sugjeroi: "Pse nuk i mbledh esetë e tua dhe nuk i boton si libër?"

Dhe kur ai e sugjeroi për herë të parë, mendova se ishte një ide e bukur, por do të ishte mjaft e shkurtër, sepse më duhet të pres edhe disa vite, të bëj më shumë kërkime dhe të shkruaj se çfarë mund të shtoj. Dhe e dija gjithashtu se botuesit, në përgjithësi, sot nuk janë të kënaqur me koleksionet që thjesht paraqesin gjëra të botuara tashmë. Jo, nëse është një material qind për qind kështu. Ata duan materiale të reja, për një libër të ri. Ata duan të kuriozojnë lexuesit e tyre. Dhe mendova, kam disa tema për të cilat dua të shkruaj, dhe mund të jetë një artikull mjaft i gjatë, më i gjatë se një artikull normal në një revistë akademike, më i gjatë se diçka që mund ta referoj në një punim konference, që mund të botohet. Ato punime janë zakonisht 10 deri në 20 faqe. Unë kisha disa tema që doja të eksploroja në një lidhje të shkëlqyer. Kështu, mendova, mirë atëherë, do t'i jap kohë vetes, do t'i hulumtoj këto tema dhe do të kisha luksin të shkruaja, sa të doja. Mund të jetë shumë më i gjatë. Sepse tani, unë mund t'i bashkoj të gjitha gjërat në një libër dhe sa më të reja t'i kem materialet, aq më mirë do të jetë.

Kështu ndodhi. Pra, studimet më të hershme, të botuara më parë: disa prej tyre ishin një lloj nënprodukti i hulumtimit tim për historinë e Kosovës, një leksion që mbajta për Pjetër Bogdanin dhe librin e tij të famshëm, që në fakt ishte si leksion përurues kur u pranova anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Kosovës, një artikull i mrekullueshëm për eksodin e serbëve nga Kosova në vitin 1690, një ese mbi kriptokrishtërimin, Rrethin e Laramanit, kriptokristianët e Kosovës. Këto janë botuar edhe në një artikull për kelmendasit, për historinë e hershme të këtij fisi, i cili është një nga më të shquarit midis asaj ane që e quajnë Malësi. Kështu që, ja si u mblodhën edhe materiale të reja. Ato përfshinin një studim përshkrues të pelegrinëve në Shqipërinë e shekullit të 15-të, pelegrinëve që shkonin nga Venecia në Jerusalem, që dikur ndalonin në Durrës. Aty ka histori që nuk janë vënë re më parë, dua të them, ndoshta, sepse dy më të rëndësishmet

janë në hollandisht dhe një në çekishten e vjetër. Çekishtja e vjetër nuk është një gjuhë e lehtë për t'u lexuar, është shumë e ndryshme nga çekishtja moderne. Kështu që më interesonte, kisha mbledhur shumë materiale për shqiptarët në duart e inkuizicionit në shekujt 16, 17, 18. Dhe këto më interesuan shumë. Unë kam punuar për arsye të tjera në arkivat e inkuizicionit në Itali, Maltë dhe Spanjë, por mendova se kjo ishte diçka shumë e veçantë. Sepse, inkuizicioni i pyeste njerëzit për historinë e tyre personale dhe regjistronte në detaje atë që ata thoshin. Shumica e këtyre rasteve përfshijnë njerëz që u konvertuan në Islam, në një moment të jetës së tyre. Dhe tani, ata ishin në territorin e krishterë. Disa prej tyre u kapën si skllevër, u mbajtën në Napoli ose Venecia, dhe donin të ktheheshin në të krishterë; Inkuizicioni duhej t'i ndëshkonte, sepse kishin kryer një mëkat të tmerrshëm duke e braktisur atë dhe duke u konvertuar në Islam.

Pra, lindnin këto pyetje të hollësishme dhe ndonjëherë kishte edhe përgjigje po aq të hollësishme për jetën e hershme. Dhe mendova se kjo ishte e jashtëzakonshme. Sepse, nga ajo periudhë, është kaq e rrallë të kesh shqiptarët e zakonshëm që përshkruajnë historinë e jetës së tyre. Është e jashtëzakonshme. Ne dimë shumë pak për jetën personale të dikujt në atë periudhë. Dimë për Skënderbeun dhe disa anëtarë të familjes së tij. Ne dimë për disa priftërinj që i kanë shkruar shumë Romës, si Pjetër Bogdani dhe familja e tij, prej nga kemi korrespondencën e tij personale. Por, në përgjithësi, njerëzit e thjeshtë, fshatarët, peshkatarët, nuk shihen gjëkundi. Prapë se prapë, ndonjëherë ka rrëfime mjaft të detajuara, madje edhe rrëfime të detajuara të grave shqiptare të kësaj periudhe. Dhe kjo, për një historian është me të vërtetë pluhur ari, është kaq i rrallë dhe kaq i veçantë. Pra, i mblodha ato në një kapitull mjaft të gjatë.

Por kapitulli më i gjerë ishte ai për Ali Pashë Tepelenën.

Atje kam bërë shumë punë. U përpoqa të lexoja të gjitha dëshmitë e dorëshkrimit, në të gjitha arkivat në Angli. Sepse britanikët kishin shumë lidhje me të gjatë luftërave Napoleonike.

Ai ishte shumë i rëndësishëm për strategjinë britanike, dhe natyrisht, ai ishte i rëndësishëm për strategjinë franceze. Dhe unë kalova shumë kohë në arkivat diplomatike franceze dhe ato konsullore.

Pra, kur e shkrova, si për habinë time, doli pothuajse si një libër i shkurtër, rreth 150 faqe. Por mendova ta vendos në librin tim. Është një ese e gjatë, por do të përfshihet në atë libër. Dhe së fundi, gjeta një dorëshkrim shumë interesant në një arkiv të vogël në Itali, që ishte një autobiografi e një të riu, shkruar në fund të shekullit të 19-të, në Shkodër. Ai e shkruan italisht, duke përshkruar jetën e tij si fëmijë dhe student në Shkodër, dhe donte të bëhej prift katolik. Ai u refuzua, por me përshkrime të gjalla të jetës së zakonshme atje, dhe askush nuk e kishte parë këtë përpara; vetëm të ulej në këtë arkiv. Pra, kam shkruar një kapitull mjaft të gjatë për këtë. E quajta autobiografia e parë shqiptare. Është

autobiografia e parë  e shkruar nga një shqiptar në Shqipëri, e cila ka arritur deri në ditët tona.

Pra, ky ishte materiali i ri dhe i tëri mundet të konsiderohet një libër, i cili e përshkon historinë që nga shekulli i 15-të deri në shekullin e 20-të.

**72.- Prof. Neritan Ceka**

Libri i Noel Malcolm-it, "Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit" përmbledh në njëfarë mënyre, të gjithë vizionin e tij mbi historinë e Shqipërisë,  edhe më shumë se kaq.

Nga ky libër, i cili i kushtohet një personaliteti të madh të kulturës shqiptare, që ishte Robert Elsie, dua të evidentoj të paktën katër çështje që më kanë bërë përshtypje në ndërtimin e strukturës së këtij libri.

Së pari, ka një pamje të ndryshme të Shqipërisë së shekullit XV.

Ka një vështrim që niset nga dokumentet Perëndimore, veçanërisht të arkivave të Venecias një tjetër që niset nga dokumentet Osmane dhe një krejt i ri i Noel Malcolm-it, i cili niset nga përshtypjet që kanë pasur pelegrinët të cilët përshkonin bregdetin shqiptar e nganjëherë stacionoheshin në një nga portet e Shqipërisë së asaj kohe,  Shqipërinë e shek. XV.

Për kufijtë e Shqipërisë, që sipas këtyre pelegrinëve fillojnë nga Gjiri i Kotorrit, nga Budva, ku pelegrinët shohin shqiptarët me zakonet e tyre, dëgjojnë gjuhën shqipe dhe kjo tregon qartë që të paktën në drejtim të veriut, për të mos thënë pastaj edhe të jugut, sepse përballë Korfuzit shikon kudo, pelegrinët shikojnë shqiptarët dhe gjuhën shqipe.

Që nga vitet e mesit të shekullit XV, kur na dalin këto burime e deri në vendosjen e kufijve të Shqipërisë, kemi patur një tkurrje të fortë të kombit shqiptar.

Pra, në sytë e pelegrinëve, Shqipëria është pjesë e botës Perëndimore, ku ruheshin akoma kështjellat deri tek majat e pirgjeve. Një nga ato gjërat më interesante, të cilat na kanë ardhur në mënyrë  indirekte, por në kohë më të vonë:

Në Durrës ekzistonte "Porta e Kalorësit", për faktin që mbi portë ishte vendosur një skulpturë ekuestre e një kalorësi mbi një kalë bronxi, i cili mbante një fjalim në dorë, pra kishte të shkruar: "Këtu është Udha", që mund të merret sikur është ''Rruga Egnantia'' sepse ishte porta tokësore.

Por Noel Malcolm, me shumë zgjuarsi përcakton se ky kalorës s'është dikush tjetër, por Konstandini i Madh që tregon Rrugën e Krishtit.

Kjo shpjegon edhe faktin që skulptura u ruajt gjatë gjithë shekullit XV, deri në pushtimin turk.

Sepse Konstandini i Madh ishte njëkohësisht një nga themeluesit e krishtërimit, sipas ideologjisë së krishterë.

**73.- Lord Stuart Peach**

Do të dëshiroja t'i bëja një nderim të veçantë Sir Noel Malcolm-it, si një nga ekspertët kryesorë të historisë shqiptare. Kam lexuar shumë nga librat e tij. Shkrimet e tij për historinë dhe gazetaria e tij, kontribuojnë si për të kuptuar Shqipërinë dhe shqiptarët, ashtu edhe për rajonin madje edhe më gjerë.

Libri i tij i fundit quhet "Rebelë, besimtarë, të mbijetuar", studime për historinë e shqiptarëve. Është një koleksion magjepsës artikujsh që nxjerrin në pah rolin historik të Shqipërisë, si pikëtakimi, pikëkalimi për kultura, fe dhe popuj të ndryshëm.

**74. - Bejtullah Destani**

Historia e "Rebelëve…" me artikujt e Noel Malcolm, libri i fundit, ka të bëjë me Ernesto Cozzi-n, i cili ka qenë ambasadori i parë i Vatikanit në Shqipëri dhe një erudit i jashtëzakonshëm, dhe që ka lënë disa ditare të pabotuara. Një pjesë të madhe Noeli i ka gjetur në një kishë afër Milanos, si dorëshkrime. Dhe ato si prift, edhe si antropolog shumë i vyeshëm. E ka ndihmuar jashtëzakonisht popullin shqiptar në zonat ku ka banuar, pasi ka qenë prift i thjeshtë, edhe ka bërë disa gjëra praktike; i kishte ndihmuar për ujësjellës, u kishte sjellë ujësjellësin në një fshat, ndihmuar njerëz të cilit nuk i kishin gjërat elementare. Edhe si ambasadori i parë i Vatikanit në Shqipëri dha një kontribut të jashtëzakonshëm, dhe ai e humbi jetën tragjikisht. Është një artikull vërtet shumë interesant.

Mandej ka një artikull për Lidhjen e Prizrenit, që flet për qëndrimin britanik ndaj Lidhjes së Prizrenit. Një artikull tjetër është për Ali Pashën, një artikull shumë i gjatë, që e përmenda. Ka një artikull tjetër për biografin e parë, që ka shkruar biografinë e autobiografinë e parë, në italisht; ishte një shqiptar nga Shkodra. Dorëshkrimin e ka gjetur në Trento dhe ka vazhduar, ka shkuar në Trento dhe e ka parë dorëshkrimin dhe është i pari që ka shkruar për këtë person me mbiemrin Tusha. Ka qenë tregtar dhe e ka shkruar autobiografinë e parë, në gjuhën italiane, edhe akoma është dorëshkimi i parë, i pabotuar.

Domethënë, ky koleksioni i artikujve të Noel Malcolm tregon që ka një kontinuitet të thellë për zbardhjen dhe njohjen e historiografisë shqiptare, gjërave të panjohura, dhe gjithmonë ka insituar që të riprodhohen apo përshkruhen tema të cilat nuk njihen fare.

Sipas mendimit të Noelit, pas Skënderbeut, Ali Pasha është figura kryesore e Shqipërisë, e cila faktikisht është injoruar për shumë vite në historiografinë shqiptare.

Sipas artikujve të Noel Malcolm, Ali Pasha ka qenë një figurë jashtëzakonisht me rëndësi dhe Shqipëria është përmendë se ka pasë shumë udhëtarë që kanë udhëtuar, e kanë nderuar Shqipërinë, kanë shkruar për gjërat më të bukura, ndoshta për historinë dhe për kulturën shqiptare, kur Ali Pasha ishte në pushtet.

**75.- Prof. David Abulafia**

Është, do të thosha një lloj instinkti, që dikush mund të shkojë në një arkivë ose bibliotekë dhe ju, në njëfarë mënyre, filloni të kuptoni se ai ndoqi një udhë të veçantë dhe me siguri do të gjeni diçka vërtet interesante që ai e ka, ato lloj të dhënash të veçanta.

Dhe ka shumë materiale, për shembull, për Ali Pashën dhe ju mendoni për Ali Pashën. Emri i tij shfaqet në librin "Konti i Monte Kristos", të Duma-së, dhe kështu me radhë, shumë materiale rreth tij dhe luftërave Napoleonike, që është padyshim një çështje shumë e rëndësishme, të cilën ai e ka riinterpretuar. Pra, unë mendoj se ky është një tjetër kontribut shumë i madh.

**76.- Sir Noel Malcolm**

Epo, disa shqiptarë ishin, dhe mundësia për t'i pasur ato lëvizje ishte më e fortë në rastet e shqiptarëve, për arsyet që përshkrova.

Ky pozicion i ndërmjetëm, këto lidhje personale dhe familjare, dhe fakti që ata ishin, nga pikëpamja e krishterë, ishin një popullsi kufitare.

Për shembull, ndonjëherë ndiheshin jo plotësisht të integruar në shoqërinë veneciane, ndonëse disa u integruan, siç thotë historiania e mrekullueshme italiane, Lucia Nadin, e cila ka shkruar për komunitetin shqiptar të Venecias, që jetonin në Venecia dhe u bënë qytetarë të plotë.

Disa u integruan, por një pjesë e madhe, një numër i shqiptarëve në këto territore të qeverisura nga Venediku, u ndien në një farë mënyre se iu duhej të jetonin me forcat e tyre, si tregtarë, agjentë apo çfarëdolloj pune që mund të bënin.

Ata i kishin mundësitë që nëpërmjet Venedikut, ose nëse ishin të lidhur me kishën nëpërmjet Papës dhe territoreve Papale, ose nëse kishin lidhje me Mbretërinë e Napolit, ku gjendeshin arbëreshët dhe një tjetër mbret i Napolit, i cili ishte nën sundimin spanjoll, që përbënte një dimension tjetër politik. Ata kishin mundësinë të ishin sipërmarrës mjaft të aftë dhe veprues. Dhe unë mendoj se ato janë përdorur, pjesërisht për shkak të këtyre cilësive të veçanta. Por edhe, ndoshta, sepse nuk kishte shtet shqiptar.

Ata nuk mund të konsideroheshin si rivalë, madje ata nuk mund të konsiderohen si çështje interesash, të drejtuar tek pushteti politik. Ata ishin sa periferikë, aq edhe të ndërvarur.

Kur po e shkruaja këtë, në mendjen time më erdhi një krahasim me pozitën që kishin skocezët në Perandorinë Britanike. Sepse Skocia ishte gjithmonë një pjesë shumë më e varfër e Mbretërisë së Bashkuar. Ajo nxirrte burra shumë të ashpër.

Kushtet e jetës ishin të vështira. Kjo është një tjetër ngjashmëri me shqiptarët. Dhe këta burra të ashpër, nëse kishin ambicie, duhej të largoheshin nga Skocia dhe të gjenin mundësitë të jetonin më larg. Dhe është thënë gjithmonë, në shekullin e 19-të deri në fillim të shekullit të 20-të, kur shkonin në pjesët e largëta të Perandorisë Britanike, në Afrikë ose Azi. Këto ishin disa punë, që i bënin vetëm këta njerëz. Këta ishin njerëzit që kryenin çdo punë, inxhinierët, njerëzit që drejtonin sistemin e transportit dhe siguroheshin që trenat të funksiononin. Në të vërtetë, ata ishin njerëzit që përbënin logjistikën, zyrtarët e vërtetë, që ne i quajmë nënoficerët e përfshirë në ushtri, por jo si ata ushtarët që janë në uniformë, në krahasim me zyrtarët e lartë që ulen nëpër klube dhe e kalojnë kohën duke pirë koktejle. Këta janë njerëzit që i ndotnin duart, që bënin gjithçka të funksionojë, dhe shumë prej tyre ishin skocezë.

Ndjej se në Perandorinë Osmane, shqiptarët ishin shumë të ngjashëm me ta. Kur shikon ata shqiptarë që i bënin gjërat të funksionojnë për osmanët, në Siri, në Liban, në Egjipt, në shumë pjesë të Ballkanit, mendon për të gjithë pashallarët dhe vezirët që do të viheshin në lëvizje nga sulltanët për të qenë qeveritarë lokalë, të cilët ishin shqiptarë. Këta ishin njerëz që mund t'i bënin gjërat të funksiononin.

Dhe këtë, mendoj se e kam treguar edhe në shekullin e 16-të.

**Ky libër, në thelb nuk është një histori e Shqipërisë. Nuk është aq shumë një kontribut për historinë e Shqipërisë, por është një kontribut për historinë e shqiptarëve. Dhe unë mendova se duhet të bëja diçka të tillë të vlefshme, sepse ata nuk ishin parë në këtë mënyrë më parë.**

Unë ju falënderoj për pyetjet, për faktin se keni ardhur këtu në Angli; është shumë punë për ju për të bërë vizitë këtu në Oxford.

Fund

## BIOGRAFIA E TË INTERVISTUARVE

### Alda Bardhyli, Drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Tiranë

Alda Bardhyli është drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit në Shqipëri. Ajo është e njohur si studiuese e letërsisë, publiciste.

Ka studiuar Letërsi në Universitetin e Tiranës. Prej vitit 2000, ajo ka nisur të punojë si gazetare kulture e më pas si redaktore në gazeta të njohura të kohës, si "Albania", "Dita", Shqip".

Bardhyli ka kontribut në fushën e botimeve, si drejtuese e shtëpisë botuese "Saras". Ajo ka meritën e sjelljes në gjuhën shqipe të një sërë autorësh të rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore, si dhe nxitjen e një debati kulturor me në fokus librin si organizatore e një sërë tryezash letrare.

**Alda Dizdari, muzikante shqiptaro – britanike, Angli**

Alda Dizdari, një qytetare tashmë britanike, është artiste e lindur në Shqipëri nga dy prindër muzikantë: kompozitori shumë i njohur shqiptar Limoz Dizdari dhe violinistja Adriana Dizdari.
Ajo u largua në moshë të vogël nga vendlindja e saj Shqipëria, për të ndjekur karrierën në muzikë. Ajo studioi në Rumani dhe mori një Diplomë Bachelor nga Universiteti i Bukureshtit. Më pas kreu Master në Universitetin e Illinois në SHBA dhe vazhdoi studimet e saj të avancuara në Londër, në Shkollën e Muzikës dhe Dramës "Guildhall" me David Takeno, ku gëzoi edhe bursën prestigjioze "Leverhulme String" për dy vjet.
Ajo njihet si një nga violinistet më të dalluara në Britaninë e Madhe, për sa i takon ekzekutimit të veprës violinistike të kompozitorit anglez Edard Elgar.

**Dr. Arjan Gjonça London School of Economics, Londër**

Është profesor i asociuar i Demografisë në Departamentin e Zhvillimit Ndërkombëtar. Ai ka një MSc dhe një doktoraturë në Demografi nga London School of Economics (LSE) dhe vazhdon të punojë në LSE si anëtar i plotë i stafit akademik. Mësimi i tij fokusohet në metodat demografike dhe në shëndetin e popullsisë globale.
Interesat dhe publikimet e tij kërkimore fokusohen në shëndetin dhe vdekshmërinë në vendet në zhvillim. Kërkimi i tij mbulon demografinë e Ballkanit (me fokus të veçantë në Shqipëri); Tranzicioni shëndetësor në shoqëritë në zhvillim dhe në tranzicion.

**Bejtullah Destani, studiues, diplomat, themelues dhe drejtues i Qendrës për Studime Shqiptare, Londër**



Bejtullah Destani është studiues shqiptaro-britanik, i cili ka mbaruar studimet në Shkenca Politike në Beograd. Më 1986, ka publikuar në Beograd librin e tij të parë, "Bibloigrafi e zgjedhur e librave mbi Shqipërinë, 1850-1984".
Për shkak të situatës gjithnjë e më të rënduar në vendlindjen e tij në Kosovë, në vitin 1991 ai emigroi në Londër, Mbretëria e Bashkuar.
Destani ia ka dedikuar jetën e tij studimeve shqiptare, në veçanti kërkimeve mbi marrëdhëniet kulturore britaniko-shqiptare dhe ka bërë zbulime të rëndësishme për historinë shqiptare në bibliotekat dhe arkivat britanike, gjermane, austriake, italiane, turke e më gjerë. Në tetor 2008, ai u emërua Sekretar i Parë i Ambasadës së Republikës së Kosovës, të sapohapur në Londër dhe në nëntor 2009 emërohet Ministër Këshilltar. Më pas ai emërohet në të njejtën detyrë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë, dy terma me ndërpreje.
Ai është themeluesi i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër.
Ai ka botuar një listë të jashtëzakonshme librash rreth historisë së shqiptarëve në përgjithësi, dhe të Kosovës në veçanti.

**Lord Charles Moore, Baron Moore i Etchingham, Dhoma e Lordëve, Londër**




Charles Hilary Moore, Baron Moore i Etchingham – it, (lindur më 31 tetor 1956) është një gazetar anglez dhe ish-kryeredaktor i gazetave ''The Daily Telegraph'', ''The Spectator'', ''The Sunday Telegraph".

Ai njihet si biografi i autorizuar i Margaret Thatcher-it, botuar në tre vëllime, më 2013, 2016 dhe 2019.

Moore studioi në Trinity College, Cambridge, në të njëjtën kohë me Noel Malcolm, në Kolegjin Eton.

Në vitin 1979, ai iu bashkua "The Daily Telegraph" si korrespondent politik.

Dy vjet pasi iu bashkua "The Spectator" si kolumnist politik, Moore u bë redaktor i revistës në 1984, duke qëndruar atje deri në vitin 1990.

Në atë kohë, Charles Moore punësoi një gazetar të ri të quajtur Boris Johnson në "The Spectator", i cili e pasoi Moore si redaktor i "The Spectator" dhe më pas u bë Kryetar i Bashkisë së Londrës, Sekretar i Jashtëm Britanik dhe Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar.

Baroni Charles Moor i Etchingham është Anëtar i Dhomës së Lordëve që nga 13 tetori 2020.

**Dr. Daut Dauti historian shqiptaro – britanik**

Daut Dauti është historian, gazetar dhe shkrimtar. Ai e ka filluar profesionin e gazetarit gjatë kohës kur studionte Drejtësi, në Universitetin e Prishtinës. Studimet post-diplomike të drejtimit të politikës dhe ekonomisë europiane, i ka kryer në West London University (ish - Thames Valley University), kurse studimet e doktoraturës (PhD) në shkollën e Historisë, University of Leeds. Daut Dauti është autor i librit "Britain, the Albanian Question and the fall of the Ottoman Empire 1876-1914" dhe "Lufta për Trepçën". Po ashtu, ai është autor dhe bashkëautor i disa librave dhe punimeve shkencore të botuara në disa gjuhë dhe vende të ndryshme.

**Prof. David Abulafia, Profesor Emeritus, Universiteti i Kembrixhit, Angli**

Profesor David Abulafia, (lindur më 12 dhjetor 1949) është një historian anglez me një interes të veçantë për Italinë, Spanjën dhe pjesën tjetër të Mesdheut, gjatë Mesjetës dhe Rilindjes. Ai e kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij në Universitetin e Kembrixhit, duke u ngritur për t'u bërë profesor në moshën 50-vjeçare. Ai doli në pension në vitin 2017, si Profesor "Emeritus" i Historisë së Mesdheut. Ai është anëtar i Kolegjit "Gonville and Caius", Kembrixhit. Ai ishte Kryetar i Fakultetit të Historisë në Universitetin e Kembrixhit, 2003-5, dhe u zgjodh anëtar i Këshillit drejtues të Universitetit të Kembrixhit në vitin 2008.

**Dr. David Shankland, Drejtor i Institutit Mbretëror Antropologjik, Londër**

Dr. David Shankland është drejtor i Institutit Mbretëror Antropologjik, në Londër.
Ai u trajnua në Antropologji Sociale në Universitetin e Edinburgut, më pas u zhvendos në Cambridge për studimet e doktoraturës, gjatë të cilave kreu punë në terren në Anadoll, duke parë veçanërisht çështjet e ndryshimit shoqëror, politikës dhe fesë. Në 1995, David mori një leksion në Universitetin e Uellsit "Lampeter", më pas u transferua në Universitetin e Bristolit, në 2003.
Ai ka luajtur një rol udhëheqës në shumë institucione antropologjike, duke qenë bashkëorganizator i konferencës së Shoqatës Europiane të Antropologëve Socialë në Bristol, Kryetar i konferencës ASA "Imagjinatat Antropologjike dhe Arkeologjike: e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja", dhe në 2009, president i Seksionit të Antropologjisë dhe Arkeologjisë të Shoqatës Britanike të Shkencës.

**Dr. Edita Tahiri, ish - Ministre e Jashtme e Kosovës**

Edita Tahiri, e lindur më 29 korrik 1956, është nismëtare e pavarësisë së Kosovës, ish-zëvendëskryeministre, ministre e Punëve të Jashtme dhe negociatore për paqen. Ajo ka qenë edhe ministre e Dialogut, ministre e Administratës Publike dhe deputete në pesë mandate. Ajo ishte kryenegociatore e Republikës së Kosovës për shtatë vite (2011-2017) në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, me mbështetjen e SHBA-së, për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore me Serbinë. Ajo ka qenë ministre e Punëve të Jashtme të Kosovës për dhjetë vjet, në kohën e vështirë të çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës (1991–2000). Ajo është nënshkruese e Deklaratës së Pavarësisë të Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

**Edith Harxhi, ish zv/Ministre e Punëve të Jashtme të RSH**

Edith Harxhi është Drejtore Ekzekutive e Qendrës së Politikave Shqiptare, një institut që merret me këshilla, analiza dhe kërkime mbi politikat e jashtme dhe sigurinë në Shqipëri dhe në Ballkan. Ajo ka shërbyer si Zëvendës Ministre e Jashtme e Republikës të Shqipërisë, 2005 – 2013.

Zonja Harxhi shërbeu për shumë vite si e dërguar speciale e qeverisë shqiptare për njohjen e Pavarësisë së Kosovës, ku vizitoi shumë kryeqytete botërore dhe organizata ndërkombëtare duke lobuar për pavarësinë e Kosovës. Znj. Harxhi ka punuar për Kombet e Bashkuara dhe ka shërbyer si këshilltare e Zëvendës Përfaqësueses Speciale të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ku ka mbuluar sigurinë dhe drejtësinë, si dhe çështjet e minoriteteve dhe gjinive. Zonja Harxhi është diplomuar për shkenca politike në Universitetin e Edinburgut, në Mbretërinë e Bashkuar.

**Harry Eyres, NEWSWEEK, gazetar, shkrimtar dhe poet anglez, Londër**

Harry Eyres u arsimua në kolegjin "Eton", në kolegjin "Trinity", Cambridge. Ai ka diplomën "De Estudios Hispanicos" nga Universiteti i Barcelonës dhe një diplomë mastër në Vlerësimin Mjedisor, nga London School of Economics (LSE).

Eyres ishte një kritik dhe shkrimtar arti për "The Times", redaktor i verërave për "Harpers & Queen" dhe kolumnist për verërat për revistën "The Spectator". Ai ka qenë redaktor i poezisë në "Daily Express", nga viti 1996 deri në 2001. Para se të merrej me shkrime, në fillimet e tij në vitet 1980, ai ishte një ekspert i ri në departamentin e verërave të Christie's, duke punuar nën kujdesin e kritikut të verës, Michael Broadbent.

Eyres është autor i "Horaci dhe Unë:Mësime jete nga një poet i lashtë" (2013),

"Udhëzues fillestar për Republikën e Platonit" (2001),

"Dinastitë e verërave të Europës: Portrete personale të dhjetë shtëpive kryesore" (1990), disa libra mbi verën, si dhe një vëllim me poezi, i titulluar "Hotel Elisio" (2001). Ai është gjithashtu bashkëautor i fjalorit "Johnson's Brexit" (2018).

**Isa Zymberi, ish-diplomat, shkrimtar, pedagog dhe përkthyes**

Isa Zymberi është një njohës i shkëlqyer i gjuhës angleze, pedagog dhe autor tekstesh të asaj gjuhe. Po ashtu, ai është pedagog i gjjuhës shqipe. Për këtë arysye, ai ka përdorur këto aftësi për mësimin recipok të folësve të këtyre dy gjuhëve. Libri i tij "Shqipja pa mësues" është bërë prej shumë kohësh i njohur, si një metodë për mësimin e shqipes. Ai ka qenë edhe drejtues i Zyrës së Informacionit të Kosovës për Britaninë e Madhe, e njohur si QIK, në periudhën e paraluftës dhe para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, nën drejtimin e qeverisë në azil të dr. Bujar Bukoshit, nën drejtimin e Presidentit Ibrahim Rugova. Ai ka shërbyer edhe si një linjë diplomatike përfaqësimi e kësaj qeverie në ekzil, në Britaninë e Madhe. Ai ka merita të veçanta për ndërkombëtarizmin e çështjes së Kosovës në Britaninë e Madhe dhe më gjerë.

**Prof. Jason Hunter Tomes, pedagog dhe shkrimtar, Universiteti i Oksfordit, Angli**

Prof. Jason Tomes është studiues i njohur i Historisë dhe Politikës, në Universitetin e Oksfordit dhe Boston. Ai ka një CV të pasur me botime, përfshirë edhe studime lidhur me Shqipërinë dhe rajonin tonë. Një prej librave më të njohur në Shqipëri është "King Zog: self-made monarch of Albania". Ai ka qenë gjithashtu editor në disa botime të tjera që lidhen me Shqipërinë, si dhe pjesëmarrës në disa konferenca në Tiranë.

Instituti i Historisë pati kënaqësinë ta ketë pjesë të ekipit të referuesve në konferencën shkencore të nëntorit 2022, mbi 100 vjetorin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe.

**John Hodgson, përkthyes i librave të Ismail Kadaresë, Londër**

Hodgson është anëtar aktiv i Shoqatës Anglo – Shqiptare në Londër.

Ai i ka kryer studimet për letërsi angleze në Cambridge dhe Newcastle. Ndërkohë ai ka punuar si përkthyes me shkrim dhe me gojë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Hagë.
Ai ka përkthyer pesë romane të Ismail Kadaresë, duke përfshirë "Kamarja e Turpit", dhe disa vepra të Fatos Lubonjës, duke përfshirë "Dënimi i Dytë" dhe "Apokalipsi i rremë".

**Lea Ypi, Profesore e Teorisë Politike, London School of Economics, Londër**

Lea Ypi është profesore e Teorisë Politike, në London School of Economics në Londër dhe profesore Nderi e Filozofisë, në Universitetin Kombëtar Australian.

Me origjinë nga Shqipëria, ajo ka diplomuar në Filozofi dhe Letërsi nga Universiteti i Romës "La Sapienza", ka marrë një doktoraturë nga Instituti Universitar Europian, si dhe ka qenë një studiuese e Çmimit Post-Doktoraturë në kolegjin "Nuffield", të Universitetit të Oksfordit.

Ajo është autore e "Drejtësia Globale dhe Agjencia Politike Avant-Garde, Kuptimi i Partizanizmit" (me Jonathan White) dhe "Arkitektonia e Arsyes", të gjitha të botuara nga Oxford University Press.

Libri i saj i fundit, "E lirë", botuar nga Penguin Press dhe i përkthyer në më shumë se njëzet e pesë gjuhë, ka fituar çmimin "Ondaatj" të Shoqërisë Mbretërore të Letërsisë më 2022, Çmimin e Biografisë së Parë "Slightly Foxed" dhe është përzgjedhur, ndër të tjera, për çmimin "Baillie Gifford" dhe çmimin "Kosta".

Puna e saj akademike është vlerësuar me Çmimin e Akademisë Britanike për Ekselencë në Shkenca Politike dhe një Çmim *Leverhulme* për arritje të jashtëzakonshme në kërkime.

**Lutfi Dervishi, studiues, gazetar, Tiranë**

Lutfi Dervishi është gazetar, redaktor, trajner dhe pedagog me përvojë i Gazetarisë. Ai është themelues dhe trajner në Qendrën Shqiptare për Gazetari Cilësie. Me ekspertizë të gjerë në media, z. Dervishi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e medias. Ai shërbeu si Drejtor Ekzekutiv i "Transparency International Albania", nga viti 2008 deri në vitin 2013. Gjithashtu, ai ka punuar si komentator politik për rrjete të ndryshme televizive dhe stacione radiofonike ndërkombëtare si BBC, RFI dhe RFE. Këndvështrimet dhe analizat e mprehta të zotit Dervishi e kanë bërë atë një figurë të njohur në Shqipëri.

**Mal Berisha, studiues, ish-ambasador i Republikës së Shqipërisë në St. James's Court, Londër**



Mal Berisha është i lindur në Tropojë, Malësia e Gjakovës dhe është diplomuar në Akademinë e Arteve të Shqipërisë, në vitin 1975. Ai iu bashkua shërbimit diplomatik të Shqipërisë si Konsull dhe më pas si Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë në Stamboll, në vitet 1992 – 1997. Më pas iu bashkua Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK nga viti 2000 deri në vitin 2009 duke vazhduar më pas të punojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë deri në shkurt të vitit 2012. Atë vit, deri në nëntor të vitit 2015, ai ka shërbyer si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës, (2012 - 2015)

Ai është autor i disa librave ndërsa së fundmi është angazhuar në realizimin e një sërë filmash dokumentarë kushtuar studiuesve anglo-amerikanë studimet e të cilëve kanë hedhur dritë mbi të vertetat mbi historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Ky film dokumentar shënon vijimin e punës së tij në këtë drejtim.

**Dr. Melanie McDonagh, gazetare angleze, The Spectator, Londër**

Melanie McDonagh është një gazetare shumë e njohur britanike. Ajo ka studiuar në New Hall, Cambridge History, (universitare), Gonville & Caius, University of Cambridge – History (PhD). Ajo ka punuar për "Daily Telegraph", dhe "Sunday Times".
Ajo ka shkruar artikuj të shumtë në gazeta dhe revista të ndryshme britanike.Ajo ka qenë një zë i fuqishëm në mbështetje të shqiptarëve të Kosovës, të cilët po vuanin nën regjimin e Millosheviçit, kundër mizorisë së ushtruar ndaj tyre.
Aktualisht ajo shkruan në revistën "The Spectator".
Ajo ka udhëtuar disa herë në Shqipëri dhe Kosovë dhe ka shkruar artikuj me interes të lartë.

**Michael Gunn, artist britanik, historian shkrimtar, Londër**

Është anëtar i komitetit ekzekutiv të shoqatës Anglo - Shqiptare në Londër, AAA.
Ai është shkrimtar dhe historian, i cili për shumë vite i është kushtuar antropologjisë sociale të periudhave mesjetare, të rilindjes dhe pas - rilindjes në Europë dhe gjetkë, me theks të veçantë në krijimin, zhvillimin dhe historinë e sistemeve të bazuara në Fise.
I trajnuar si fotograf specialist i dorëshkrimeve të lashta dhe librave të rrallë të hershëm, puna e tij përfshin udhëtime në të gjithë Europën, përfshirë Ballkanin.

Ai ka vizituar shumë arkiva dhe biblioteka. Gjatë punës së tij, ai ka rënë në gjurmët e koleksioneve më të shquara të librave të rrallë dhe dokumenteve arkivore.
Libri "Fiset dhe familjet shqiptare të Veriut" është rezultat i më shumë se tridhjetë viteve kërkime në temën e tij pak të njohur - Fiset dhe Familjet e Mëdha Shqiptare.

**Prof. Neritan Ceka, historian, arkeolog**

Prof. Neritan Ceka ka studiuar në fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës dhe është diplomar në vitin 1962. Ai ka ndjekur trashëgiminë e babait të tij, arkeologut të parë shqiptar Hasan Ceka, duke u bërë edhe vetë një ndër arkeologët më të shquar të Shqipërisë.

Ai ka meriën e zbulimit të shumë trojeve arkeologjike, veçanërisht atë të Bylisit, si dhe gërmime dhe zbulime të tjera. Ai është i njohur për librat e tij të botuar për arkeologjinë dhe historinë shqiptare. Ai mban një varg titujsh të lartë, deri tek “Mjeshtër i Madh”.

**Profesor Rexhep Ismaili, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës**

Ka lindur në Preshevë ndërsa studimet për Gjuhë dhe Letërsi i mbaroi në Prishtinë më 1971. Në vitet 1971-1973 specializoi për Gjuhësi, në Institut de Linguistique Générale et Appliqué "René Descartes" (Sor-bonne), Paris.

Në vitin 2002 u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve me seli në Salzburg. Ai është antëar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në tetor 2002 u zgjodh Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Më 2005 u rizgjodh Kryetar i ASHAK-ut. Në mandatin 2008-2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës e zgjodhi Kryetar të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

Ai ka qenë përkrah Dr. Ibrahim Rugovës në përpjekjet e tij për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

**Robert Archibald Wilton, shkrimtar, diplomat dhe studiues britaniko-kosovar**

Robert Wilton, i lindur më 22 shkurt 1973, është një shkrimtar britaniko-kosovar. Ai e ka kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij në Ballkan, duke përfshirë si këshilltar i kryeministrit të Kosovës dhe si zëvendës ambasador për Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Si shkrimtar, ai njihet për serinë e tij të romaneve historike "Kontrolli i Përgjithshëm", për të parin prej të cilëve u nderua me Kurorën e Shoqatës së Shkrimtarëve Historikë.

Në vitin 2012, Wilton u nderua me kororën e Shoqatës së Shkrimtarëve Historikë "Goldsboro Books Crown" për romanin më të mirë historik, debutues për "The Emperor's Gold".

**Dr. Rudina Jasini, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Oksfordit, Angli**

Rudina Jasini ka kryer studimet në Kriminologji dhe Drejtësi Penale si studiuese e Weidenfeld, në vitin 2009. Përpara se të shkonte në Oksford, ajo ka punuar si avokate në Gjykatën Penale Ndërkombëtare të OKB-së për ish-Jugosllavinë (ICTY). Rudina është diplomuar në Drejtësi dhe mban gradën e doktores në Kriminologji dhe Drejtësi Penale nga Universiteti i Oksfordit, si dhe mastër në Studime Juridike Ndërkombëtare nga Qendra Juridike e Universitetit Georgetown, dhe gradë bachelor në Drejtësi nga Universiteti i Tiranës.Aktualisht, Përveç kësaj, Rudina është këshilltare ligjore në ekipin e mbrojtjes në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Më parë, Rudina është emëruar si Anëtare Globale Postdoktorale në Qendrën Universitare të Nju Jorkut për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësinë Globale. Ajo gjithashtu ka mbajtur takime si referuese vizitore në Shkollën Juridike të Harvardit, Shkollën Juridike të Nju Jorkut dhe Institutin "Max Planck" për të Drejtën Penale të Huaj dhe Ndërkombëtare.

**Lord Stuart Peach, Baron Peach, Shefi i Ajrit Marshall**

Shefi i Marshallit Ajror Lord Stuart William Peach, Baron Peach është një oficer i lartë britanik në pension i Forcave Ajrore Mbretërore. Ai u emërua komandant i forcave ajroro të NATO-s  në Kosovë në vitin 2000. Ai vazhdoi të jetë Shef i Inteligjencës së Mbrojtjes në vitin 2006, Shef i Operacioneve të Përbashkëta në vitin 2009 dhe Komandanti i parë i Komandës së Forcave të Bashkuara në dhjetor 2011.

Ai pasoi gjeneralin Petr Pavel si Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s më 29 qershor 2018, duke shërbyer si i tillë deri në pensionimin e tij nga NATO në qershor 2021.

Lord Peach është i dërguari i posaçëm  i kryeministrit britanik në Ballkan.

FUND